

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në "Kontabilitet"

Ofruar nga Kolegji Universitar „Luarasi“

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Etleva Bajrami

2. Prof.Asoc.Dr. Rezarta Shkurti

(Gusht/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP në „Kontabilitet“

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “Luarasi”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Ekonomik
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASR Nr 689, datë 15.10.2018
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në “Kontabilitet”
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7 (shtatë)
15	Aktivizimi i programit të studimit	2018-2019
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2018-2019
17	Numri i studentëve	12 studentë

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

KU "Luarasi" ka nisur veprimtarinë e mësimdhënies, në vitin akademik 2003–2004. Institucioni është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.611, datë:11.09.2003“Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Luarasi". KU "Luarasi" ka filluar aktivitetin e mësimdhënies me një fakultet, Fakultetin Drejtësisë.

Mbështetur në Urdhërin Nr. 483, datë 12.10.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për hapjen e disa programeve të reja të studimit të Ciklit të parë dhe të Ciklit të dytë pranë SHLUJ "Luarasi", u realizua hapja e programit të studimit të Ciklit të dytë "Master Profesional" në "Kontabilitet", me kohë të plotë, me 90 kredite, dhe kohëzgjatje 1.5 vite akademike.

Me Urdhër Nr. 188, datë 15.05.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për riorganizimin e njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë "Shkolla e Lartë Universitare Private "Luarasi" institucioni është riorganizuar në dy njësi kryesore:

- a. Fakulteti Ekonomik
- b. Fakulteti i Drejtësisë.

Aktualisht ka në strukturën e vet 3 (tre) fakultete.

1. Fakulteti i Drejtësisë
2. Fakulteti Ekonomik
3. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit

Për arsye se programi i ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Kontabilitet", nuk ka pasur studentë të regjistruar që prej vitit akademik 2012-2013 (momenti i licensimit të programit.) dhe në mbështetje të pikës 7 të nenit 35 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ky program studimi është mbyllur.

Senati Akademik me vendim Nr 18, datë 12.03.2018 ka marrë vendimin për hapjen e Masterit Profesional në "Kontabilitet".

Me Urdhërin Nr. 689, dt. 15.10.2018 të Ministrisë Arsimit Sportit dhe Rinisë është miratuar hapja e programit "Master Profesional" në "Kontabilitet" me 60 kredite dhe kohëzgjatje 1 vit.

KU "Luarasi" është Akredituar Institucionalisht sipas Vendimit Nr. 115, datë 15.12.2017 të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Masteri Profesional" në "Kontabilitet" ofrohet nga Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Financë-Bankës. Viti i fillimit të programit të studimit të Ciklit të Dytë të studimit "Master Profesional" në "Kontabilitet" është viti 2018-2019.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof.asoc.Dr. Etleva Bajrami
2. Prof.asoc.Dr. Rezarta Shkurti



Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi studimi është Specialistia në ASCAL, Znj Suela Kromidha

Më datë 24.07.2019 nëpërmjet sistemit AMS por edhe me shkresë zyrtare është dërguar në KUL Draft RVJ për këtë program studimi. Më datë 29 Korrik 2019, në ASCAL ka ardhur përgjigja nga Institucioni mbi këtë Draft. Institucioni ka bërë disa komente në lidhje me Draft RVJ, komente të cilat u panë me kujdes nga GVJ dhe u përgatit edhe përgjigja për to, si më poshtë:

Kthim përgjigje e Grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ) mbi konstatimet e Institucionit për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit MP. "Kontabilitet" në Kolegjin Universitar "Luarasi"

GVJ për programin e studimit MP në Kontabilitet në Kolegjin Universitar Luarasi i pa me kujdes dhe shqyrtoi çdo përgjigje të Institucionit në lidhje me Draft RVJ e programit MP në "Kontabilitet". Në lidhje me këtë përgjigje, GVJ merr parasysh disa prej tyre duke bërë ndryshim në Raportin përfundimtar të vlerësimit të jashtëm. Përgjigja e GVJ për cdo kontestim apo sqarim të Institucionit, e gjeni sa më poshtë:

1. **Draft Raporti, faqe 2**, tabela e të dhënave të licensimit për programin e studimit,
Përgjigja e IAL: Duhet korigjitur cikli i studimit, Cikli II
Përgjigja e GVJ: GVJ është dakord me këtë konstatim. **Pranohet duke bërë ndryshimin përkatës në raportin përfundimtar.**
2. **Draft Raporti, Faqe 10**, paragrafi "Tabela me moshën e stafit" është marrë nga RVB; gjatë vizitës u konstatuan gabime dhe u informuam se do të saktësohej, por nuk kemi informacion të përditësuar në lidhje me këtë tabelë.

Përgjigja e IAL: tabela e moshës e korigjuar është dërguar me dokumentat plotësuese dt 05 korrik 2019 (formati excel).

Përgjigja e GVJ: GVJ është dakord me këtë konstatim, tabela e moshës e korigjuar është dërguar me dokumentat plotësuese dt 05 korrik 2019 (formati excel) dhe është ajo Tabelë që është vendosur në RVJ, por komenti është harruar pa u hequr.

Gjithsesi GVJ vëren qe Tabela e dërguar me Kthim përgjigjet nga IAL nuk është identike (ka një ndryshim) me Tabelën e dërguar pas vizitës në institucion. Vihet re në të dyja tabelat qe është shënuar tek tabela: Numri i PAK me moshë: Asistentë me Msc – nr 1 me moshë (56-65), ndërkohë që në Tabelën 4 në (RVB): Stafi akademik për programin e studimit MP në "Kontabilitet" për vitin akademik 2018-2019 jepen 4 PAK dhe asnje me Msc. GVJ ka bërë korigjimin në Tabelën 6/2 Numri i PAK me moshë, duke mos e përfshirë në tabelë: Asistentë me Msc –nr 1 me moshë (56-65). **GVJ do të ndryshojë paragrafin në faqen 10.**

3. **Draft Raporti. Fq. 10, paragrafi 1:** "Nga vizita në institucion dhe konkretisht në Zyrën e Burimeve Njerëzore, u evidentua se kontratat e punës nuk përmbanin Disiplinën ku zhvillonte mësim stafi akademik PAE dhe PAK, CV jo të gjitha ishin të përditësuara dhe mungonte në një rast edhe fotokopja e kartonit të Doktoraturës".

Përgjigja e IAL: Në kontratën e punës përcaktohet vetëm fakulteti dhe departamenti ku bën pjesë pedagogu, ndërsa lënda që jep ai është e përcaktuar në aneks kontratë që është pjesë përberëse e kontratës. Kopja e kartonit të përmendur u vu në dispozicion menjëherë pas vizitës.

Përgjigja e GVJ: GVJ konstaton që në RVJ ndodhet vetëm një pjesë e këtij paragrafi. Në RVJ gjendet paragrafi "Nga vizita në institucion u evidentua se kontratat e punës nuk përmbanin Disiplinën ku zhvillonte mësim stafi akademik PAE dhe PAK", për të cilin GVJ ruan të njëjtin qëndrim. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

4. **Draft Raporti Fq. 11, standarti 3.1:** "Në Zyrën e burimeve njerëzore na u komunikua se nuk kanë një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante pranë zyrës së Burimeve Njerëzore rekrutimi.

Përgjigja e IAL: Konstatimi i GVJ është korrekt, por mund të shtohet se GVJ është sqaruar në takim me Zyrën e Burimeve Njerëzore se është duke implementuar një sistem të menaxhimit të universitetit dhe për pjesën e burimeve njerëzore po ndërtohet një modul i veçantë me të dhëna të detajuara për pedagogët me qëllim mbajtjen e një database të plotë. Nëpërmjet koordinatorës së ASCAL në KUL iu vu në

dispozicion GVJ komunikimi mbi kërkesat e detajuara të Burimeve Njerëzore për fushat e kërkuara. Gjithashtu në takim u sqaruan se info mbi historikun e publikimeve të vendeve vakante mund të merret nga ëeb i KUL, pasi aty ruhen të gjitha publikimet.

Përgjigja e GVJ: Pas vizitës në Institucion IAL ka depozituar pranë ASCAL vetëm Rregulloren e zyrës së burimeve njerëzore. Është e saktë që gjatë vizitës na u komunikua se po ndërtohet një modul i veçantë me të dhëna të detajuara për pedagogët me qëllim mbajtjen e një database të plotë, por kjo i përket të ardhmes. GVJ i është përgjigjur Standartit 3.1 Kriteri 4 “Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.,” dhe në momentin e vizitës Institucioni nuk mbante bazë të këtyre të dhënave. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

5. **Draft Raporti: Fq. 14, Konkluzionet e vlerësimit, Pika 6:** „Institucioni duhet të respektojë në lidhje me Titullarët e lëndëve ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3.

Përgjigja e IAL: Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3 përcakton se: „Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar“. Nga më sipër nuk rezulton detyrim që titullarët e lëndëve të jenë detyrimisht nga kategoria „Profesor“. Ndërsa pika 6 e këtij ligji sqaron se: „Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës“, gjë që mendojmë se nënkupton që titullarët e lëndëve në MP duhet të kenë së paku gradën Doktor, gjë që për titullarët e lëndëve të këtij programi është realizuar. Raporti i GVJ në vlerësimin e tij duhet ti referohet aktit ligjor përkatës i cili mbështet vlerësimin e mësipërm.

Përgjigja e GVJ: Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 6 i referohet Personelit Akademik që angazhohet në mësimdhënie, ndërsa në fq. 14, Konkluzionet e vlerësimit, pika 6, GVJ i referohet Titullarëve të lëndëve. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

6. **Draft Raporti: Fq. 16, Standarti V.1 (paragrafi i fundit):** „Sipas RVB duke nisur nga viti akademik 2015 – 2016 KU “Luarasi” u siguron të gjithë personelit dhe studentëve aksesin në bibliotekën online “Questia”, por nuk ishte funksionale kur ishim në institucion gjatë vizitës“.

Përgjigja e IAL: Vlerësimi është i saktë për ditën e vizitës, sistemi ka patur probleme, gjithësesi në RVB dërguar në dt. 31.05.2019, GVB ka bashkangjitur edhe një screen të faqes së librarisë online “Questia” (Evidenca 47 -questia biblioteka online).

Përgjigja e GVJ: GVJ është shprehur se “Sipas RVB duke nisur nga viti akademik 2015 – 2016 KU “Luarasi” u siguron të gjithë personelit dhe studentëve aksesin në bibliotekën online “Questia”, por nuk ishte funksionale kur ishim në institucion gjatë vizitës”, duke reflektuar situatën (gjëndjen) aktuale të sistemit. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

7. **Draft Raporti: Fq. 18, Standarti II.9, paragrafi 2:** „Raporti i auditit për 2018 u kërkuar nga GVJ por nuk është në evidencat e dërguara nga institucioni më 05 Korrik 2019“.

Përgjigja e IAL: Sikurse u komunikua gjatë vizitës së GVJ, (04-05. 07.2019), afati ligjor i dorëzimit të raportit të auditit nga eksperti i pavarur, për vitin 2018, është dt. 31.07.2019. Ky raport aktualisht disponohet nga institucioni.

Përgjigja e GVJ: Gjatë vizitës në institucion nuk na është komunikuar data 31.07.2019, por kishte paqartësi në lidhje me raportin. Gjatë vizitës na u komunikua se do të dërgohej nëse është dorëzuar pranë institucionit. GVJ ka vlerësuar gjëndjen në bazë të dokumentacionit të dorëzuar. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

8. Sipas draft RVJ, Faqe 23, paragrafi 1: “Veprimtaritë formuese të paraqitura në RVB janë nga A – F dhe jo nga A – E sikurse i kërkon VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018.”

Përgjigja nga IAL: Tabela e korrektuar e veprimtarive formuese me klasifikimin A-Eështë dërguar me dokumentet plotësuese në datën 5.7.2019 (formati excel).

Përgjigja e GVJ: Komenti nga KUL pranohet por nuk ka ndryshim në Raportin përfundimtar të vlerësimit të jashtëm, pasi konstatimi i GVJ i referohet pikërisht RVB dhe jo tabelave të dërguara me dokumente plotësuese të mëvonshme. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

9. Sipas draft RVJ, faqe 35, Konkluzionet e vlerësimit, pika 4: “Mund të gjenden mënyra më të larmishme për t’i angazhuar studentët më shumë, si p.sh., panele të hapura, lektorë të ftuar të specialiteteve të kontabilitetit, etj.”

Përgjigja nga IAL: Në evidencat shtesë dorëzuar në dt 5.7.2019 është bashkangjitur edhe një evidencë në lidhje me aktivitetet dhe leksionet e hapura në KU Luarasi.

Përgjigja e GVJ: Komenti nga KUL nuk ka lidhje me çfarë nënkuptohet në pikën 4 të konkluzioneve të vlerësimit nga GVJ. Ekspertët e jashtëm sugjerojnë kryerjen e aktiviteteve dhe leksioneve të hapura me personalitete të fushës së kontabilitetit në Shqipëri, mundësisht përfaqësues nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike në Ministrinë e Financave, etj, që do të ishin aktivitete me interes specifik për studentët e këtij programi studimi. Ky sugjerim jepet si përgjigje e deklaratës të vetë përfaqësuesve të Institucionit i dalë gjatë vizitës në Institucion, ku anëtarë të zyrës së karrierës u shprehën se studentët e MP në Kontabilitet kishin shfaqur mungesë interesi për t’u përfshirë në aktivitetet e jetës studentore në KUL. Në mbështetje të këtij konkluzioni GVJ sjell edhe opinione të shprehura nga studentë të programit, gjatë takimit me ta si pjesë e agjendës së vizitës në Institucion, ku studentët u shprehën shumë të gatshëm të kishin si lektorë të ftuar personalitete nga fusha e kontabilitetit dhe raportimit financiar në vendin tonë. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

10. Sipas draft RVJ, faqe 36, Vlerësimi i Treguesve të Matshëm, Të dhëna për kërkimin shkencor: “Kërkimi shkencor i përgjithshëm i Institucionit karakterizohet nga objektiva të qarta dhe strategji të mirëstrukturuara (Evidenca 34 dhe 35). Por në evidencat e dërguara paraprakisht mungojnë të dhënat për aktivitete konkrete faktike në lidhje me kërkimin shkencor. Nga takimi në Institucion dhe në bisedë me stafin e qendrës së projekteve dhe zv.rektorin për kërkimin shkencor u informuam për dy projekte ongoing: i pari i realizuar vitin e kaluar dhe i financuar nga Institucioni për vlerësimin online të pedagogëve dhe i dyti projekti “EU for innovation”. Evidenca faktike për këto projekte nuk janë dorëzuar.”

Përgjigja nga IAL: Materialet në hardcopy i janë paraqitur GVJ për t’i shikuar gjatë takimit dhe nuk është patur kërkesë për t’i ngarkuar online në sistem. Këto materiale janë në sistemin ASCAL për të gjithë GVJ-të që i kanë kërkuar gjatë proceseve të akreditimit / riakreditimit. Gjatë takimit është saktësuar dhe informuar GVJ mbi situatën reale të aktiviteteve konkrete në kuadër të kërkimit shkencor për vitin akademik 2018-2019.

Përgjigja e GVJ: GVJ në përpilimin e RVJ mbështetet në RVB dhe në evidencat e dërguara në faqen zyrtare të informacionit AMS të ASCAL. GVJ thekson sërish se në evidencat e dërguara nuk gjenden të dhëna konkrete faktike. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

11. Sipas draft RVJ, faqe 36, numri i projekteve kërkimore të fituara: “Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohen 7 projekte kërkimore të fituara, por në një tabelë që shprehet se janë aktivitete të planifikuara. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët

dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion të faktuar për këto projekte kërkimore. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 në Aneks, të dhënat janë sipas RVB.”

Përgjigja nga IAL: Saktësojmë se gjatë takimit në Institucion me zv.Rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë GVJ-së nuk i është konfirmuar 7 projekte kërkimore të fituara. Projektet e fituara dhe të zbatuara janë projekte gjithëpërfshirëse dhe jo në vecanti për Fakultetin Ekonomik. GVJ është informuar gjatë takimit për projektet e zbatuara me financim nga vetë Institucioni apo edhe projekte të aplikuara për financim nga donatorë të huaj për Fakultetin Ekonomik, të Drejtësisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, evidenca faktike nuk janë kërkuar për t’u dorëzuar.

Përgjigja e GVJ: RVJ në faqen 36, pasazhi i mësipërm për asnjë moment nuk pranon këto 7 projekte të fituara. Kjo përputhet edhe me përgjigjen e dhënë nga KUL më lart. Për më tepër RVJ në këtë pikë bazohet në tabelën nr 18 të RVB që është depozituar në ASCAL dhe që shërben si dokument zyrtar i shoqëruar me evidencat respektive në sistemin AMS. Në këtë tabelë titulli është: “Aktivitete të Planifikuara” dhe ky pasazh i RVJ nxjerr në pah pikërisht mospërputhjen e RVB në këtë pikë. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

12. **Sipas draft RVJ, faqe 36, Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL:**“Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohen 10 aktivitete shkencore të organizuara nga K.U. Luarasi, por në një tabelë që shprehet se janë aktivitete të planifikuara. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion të faktuar për këto aktivitete shkencore. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.”

Përgjigja nga IAL: Saktësojmë se gjatë takimit në Institucion me zv.rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë GVJ-së është informuar për aktivitetet shkencore të realizuara dhe evidenca faktike nuk janë kërkuar për t’u dorëzuar.

Përgjigja e GVJ: Në RVB dhe evidencat mbështetëse të tij të ngarkuara në sistemin AMS të ASCAL, i vetmi aktivitet shkencor i kryer faktikisht në nivel njësie kryesore dhe jo njësie bazë, i mbështetur me evidenca të vlefshme është Konferenca Shkencore e muajit maj 2019. Pra RVB në tabelën nr 18 të saj raporton 10 aktivitete shkencore të planifikuara (ky është edhe titulli i kësaj table), dhe pikërisht këtë fakt nxjerr në pah draft RVJ në faqen numër 36, pasazhi i mësipërm. Për më tepër nuk mund të pranojmë si GVJ, komentin e KUL se “*evidenca faktike nuk janë kërkuar për t’u dorëzuar*” pasi është apriori fakt i njohur që çfarë raportohet në tabelat në përmbajtjen e RVB duhet të jetë e suportuar nga evidenca mbështetëse gjithashtu të dorëzuara në sistem së bashku me RVB. GVB nuk ka pse të presë për kërkesë për informacione të detajuara pasi është detyrim i tij të përpilojë një raport me të gjitha referencat dhe evidencat mbështetëse të përpiluara saktë. GVJ nuk mund të mbajë përgjegjësi për këtë mungesë koordinimi në përpilimin e RVB dhe lidhjen e saj me evidencat mbështetëse, mungesë koordinimi që u pranua edhe nga përfaqësues të Institucionit gjatë vizitës. Përshtypja që GVJ krijoi ishte se mes GVB dhe njësisë për projektet nuk kishte pasur një rrjedhë të mirë të komunikimit dhe informimit dhe se kur shtroheshin pyetje për pasazhe të caktuara të RVB, asnjë prej anëtarëve të GVB nuk pranonte se kishte punuar me atë pjesë çka e la shumë të amullt dhe të paqartë opinionin e GVJ në lidhje me pikën 10 “Kërkimi shkencor”. Kjo është arsyeja, përse edhe pas vizitës në Institucion, GVJ ngeli i paqartë për këtë pjesë dhe i referohet të dhënave në RVB. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

13. **Sipas draft RVJ, faqe 37, numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL:**“Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohen 50 pjesëmarrës në aktivitete shkencore brenda Institucionit. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion të faktuar për këta pjesëmarrës. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.”

Përgjigja nga IAL: Saktësojmë se gjatë takimit në Institucion me zv.rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, GVJ është informuar për aktivitetet shkencore të realizuara dhe pjesëmarrja përkatëse në to.

Përgjigja e GVJ: Ritheksojmë edhe njëherë se në RVB dhe evidencat mbështetëse të tij të ngarkuara në sistemin AMS të ASCAL, i vetmi aktivitet shkencor i kryer faktikisht në nivel njësie kryesore dhe jo njësie bazë, i mbështetur me evidenca të vlefshme është Konferenca Shkencore e muajit maj 2019. Pra RVB në tabelën nr 18 të saj raporton 50 pjesëmarrës të planifikuar (ky është edhe titulli i kësaj table, pra aktivitete të *planifikuara*), dhe pikërisht këtë fakt nxjerr në pah draft RVJ në faqen numër 37, pasazhi i mësipërm. Për më tepër nuk mund të pranojmë si GVJ, komentin e KUL se “*evidenca faktike nuk janë kërkuar për t’u dorëzuar*” pasi dihet që çfarë raportohet në tabelat në përmbajtjen e RVB duhet të jetë e suportuar nga evidenca mbështetëse gjithashtu të dorëzuara nësistem së bashku me RVB dhe jo të pritet për t’u kërkuar si informacion.**Nuk ka ndryshime në RVJ.**

- 14. Sipas draft RVJ faqe 38, standardi III.11 Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij:** “K.U “Luarasi” deklaron në RVB se disponon një bazë plotë një të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij. Por gjatë vizitës në Institucion strukturat drejtuese shprehen se kjo bazë të dhënash është aktualisht në përpunim e sipër.”

Përgjigja nga IAL: Saktësojmë se gjatë takimit në Institucion me zv.rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë GVJ-së është informuar se baza e të dhënave e veprimtarive shkencore të personelit akademik ekziston e plotë në format excel sipas dekanateve përkatës dhe është e vërtetë që jemi në përpunim e sipër të këtyre të dhënave pasi ekipi zhvillues i KUL në bashkëpunim me dekanatet dhe ekipet e kërkimit shkencor është duke punuar në ngritjen dhe zhvillimin e një aplikacioni online, periudha shtator-tetor 2019 aktivizohet si aplikacion për t’u bërë efektiv për vitin akademik 2019-2020.

Përgjigja e GVJ:RVB duhet të raportojë aktivitetet e kryera deri më tani. Po kështu në RVJ shprehet situata faktike e konfirmuar deri në korrik 2019. Aktivitetet që planifikohet se do të ndodhin në vitin akademik të ardhshëm mund të jenë pjesë e planeve taktike të Institucionit, por nuk mund të bëhen pjesë e RVJ. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

- 15. Sipas draft RVJ, faqe 38, standardi III.11 Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij:** “K.U “Luarasi” deklaron në Raportin Vjetor (Evidenca 30) se disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit MP “Kontabilitet” por nuk ka evidencë për këtë.”

Përgjigja nga IAL: Saktësojmë se gjatë takimit në Institucion me zv.rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë GVJ-së është informuar për veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe në vecanti të personelit të angazhuar në programin e studimit MP në Kontabilitet dhe i është dorëzuar evidenca përkatëse e detajuar datë 5.7.2019. Ekipi zhvillues i KUL në bashkëpunim me dekanatet dhe ekipet e kërkimit shkencor është duke punuar në ngritjen dhe zhvillimin e një aplikacioni online, periudha shtator-tetor 2019 aktivizohet si aplikacion për t’u bërë efektiv për vitin akademik 2019-2020.

Përgjigja e GVJ:Evidenca e dorëzuar në dt 5.7.2019 (evidenca numër 14¹ nga arkiva e dokumentacionit të dorëzuar pas vizitës në Institucion), është një listë e aktiviteteve shkencore të personelit të angazhuar

¹Konstatohet me këtë rast që edhe këto evidenca janë dorëzuar disa herë (pra i njëjti document më shumë se një herë) dhe Institucioni demonstroi sërish të njëjtat problem me sistemin e referencimit mes shkresave dhe materialeve të dërguara, problem i konstatuar edhe mes RVB dhe evidencave mbështetëse të saj.

në programin e studimit MP në Kontabilitet, vetëm për vitin 2018-2019. Kjo evidencë nuk mbulon aktivitete shkencore të mëparshme dhe zor se mund të merret në konsideratë si njëbazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit MP "Kontabilitet", nëse shprehemi me gjuhën e Raportit Vjetor.GVJ nuk merr përsipër të komentojë në këtë kontekst përmbajtjen e tabelës ku konstaton se vetëm tre nga anëtarët e PAE të angazhuar me programin e studimit kanë kryer gjithashtu aktivitete kërkimore – shkencore dhe as merr përsipër të bëjë analizë cilësore për këtë bazë të dhënash, por shprehet bindshëm se kjo tabelë nuk mund të konsiderohet një bazë të dhënash e cila do të ishte më e plotë dhe që përfshin aktivitetin kërkimor – shkencor të të gjithë PAE të angazhuar me programin e studimit që nga fillimi i karrierës së tyre. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

- 16. Sipas draft RVJ faqe 38, standardi III.11 Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij:** "K.U "Luarasi" nuk ka dorëzuar evidencë se disponon një bazë të dhënash për projektet brenda dhe jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit MP "Kontabilitet"."

Përgjigja nga IAL: Saktësojmë se gjatë takimit në Institucion me zv.rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënies me jashtë GVJ-së është informuar për angazhimin e tre pedagogëve PAE, një prej të cilëve në projekte dhe dy në aktivitete mësimdhënëse.

Përgjigja e GVJ:Komenti nga ana e GVJ lidhet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit MP në "Kontabilitet" dhe nga ky personel nuk ka të angazhuar në projekte brenda apo jashtë vendit. Aktivitetet e mësimdhënies qoftë edhe jashtë vendit, nuk mund të konsiderohen nga ana e GVJ si projekte. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**

- 17. Sipas draft RVJ faqe 39, Vlerësimi i treguesve të matshëm, Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj:** "Në RVB të dorëzuar nga Institucioni (tabela nr. 19), raportohen 5 orë mësimore me lektorë të huaj. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese u kërkua informacion i faktuar për këtë. Pas kërkesës së dokumentacioneve nga GVJ institucioni ka ngarkuar dokumentin *Aktivitete dhe leksione të hapura*, por është një dokument që nuk evidenton nëse këto aktivitete janë zhvilluar në vitin akademik 2018-2019, dhe në disa raste pa specifikuar Lektorin përkatës."

Përgjigja nga IAL:Aktivitetet e raportuara janë zhvilluar gjatë vitit akademik 2018-2019 dhe konkretisht sipas tabelës së dhënë në kthim përgjigjen e institucionit.

Përgjigja e GVJ: GVJ mbështetet në dokumentet e arshivuara zyrtarisht në faqen AMS të ASCAL dhe sipas këtyre evidencave, dokumenti *Aktivitete dhe leksione të hapura* është një dokument ku: (1) mungojnë datat e leksioneve dhe aktivitetve; (2) mungon emri dhe të dhëna të besueshme të lektorit; (3) nuk përputhet emërtimi i tabelës në sitemin ASCAL me titullin brenda saj kur hapet si dokument. Pavarësisht këtyre lapsuseve GVJ ka vendosur që nëkonkluzionet e këtij standarti të mos evidentojë paqartësitë në lidhje me Aktivitetet dhe leksionet e hapura.**Nuk ka ndryshime në RVJ.**

- 18. Sipas draft RVJ faqe 39, Vlerësimi i treguesve të matshëm, Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL:** "Në tabelën 19 jepet se 1 student ka zhvilluar mobilitet por gjatë vizitës u informuam se KU "Luarasi" është pjesë e rrjetit ERASMUS por deri tani nuk ka pasur mobilitete pedagogësh apo studentësh."

Përgjigja nga IAL:Duhet saktësuar se në kuadër të programit i cili akreditohet nuk ka patur mobilitet. Ndërsa Institucioni është pjesë e ERASMUS dhe ka patur mobilitete të studentëve në nivelin Bachelor

3 studente te Fakultetit Ekonomi-Finance Banke për vitin akademik 2018 2019. Marreveshjet Erasmus per Vitin tjetër Akademik dhe me pas te cilat jane lidhur qe kete vit akademik jane si me poshtë ...”.

Përgjigja e GVJ: Pas shqyrtimit të përgjigjes nga IAL, **GVJ do të ndryshojë fjalinë e faqes 39 të RVJ,** duke shtuar në fund “për këtë program studimi”.

19. Sipas draft RVJ faqe 39, Vlerësimi i treguesve të matshëm, Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime: “Asnjë pjesëmarrës në aktivitete shkencore jashtë IAL apo jashtë vendit.”

Përgjigja nga IAL: Saktësojmë se gjatë takimit në Institucion me zv.rektoren për kërkim shkencor dhe zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, GVJ është informuar për angazhimin e tre pedagogëve PAE në projekte ndërkombëtare dhe aktivitete mësimdhënëse:

1. Prof.asoc. Dr. A. D. Sharko-angazhuar në një Projekt Ndërkombëtar të Komunitetit European si Senior në Zhvillimin e Sistemit Kompjuterik të Akreditimit të Republikës së Kosovës.
2. Prof.asoc. Dr. S. Q.- angazhuar në mësimdhënie Maqedoni-Universiteti Europës Juglindore
3. Prof. asoc. Dr. I. B.-angazhuar në mësimdhënie Kosove: Iliria University.

Përgjigja e GVJ: GVJ bazohet në tabelën nr 19 të RVB dhe në këtë tabelë Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime është lënë bosh cka nënkupton zero. Informacioni i dhënë nga KUL nuk mund të merret në konsideratë nga GVJ pasi: (1) personeli i angazhuar në projekte ndërkombëtare nuk është personel i angazhuar në mësimdhënie pranë MP në Kontabilitet dhe (2), personeli i angazhuar në mësimdhënie pranë MP në Kontabilitet nuk është i angazhuar në aktivitete shkencore por në aktivitete mësimdhënëse. **Nuk ka ndryshime në RVJ.**



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

GVJ pas konsultimit dhe shqyrtimit të një sërë dokumentash të paraqitura në Dosjen e Vërtetimit (DVV) si dhe mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi, shprehet se: Vizioni i Kolegjit Universitar Luarasi është të jetë lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare; një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve; një qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve juridike dhe ekonomike në vend, me ndikim në rajon e më gjerë; si dhe një qendër për kërkimin shkencor.

KU "Luarasi" ka për mision të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Misioni i institucionit është të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor, të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në fushat që ushtron aktivitetin akademik, të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor si dhe të realizojë bashkëpunim në nivel ndërkombëtar me institucione homologe në fushën e arsimit të lartë.

Misioni i programit të studimit është në përputhje me misionin e institucionit. Misioni i KU "Luarasi" është t'u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm; t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira dijes dhe të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare. Misioni i këtij programi studimesh për përgatitjen e specialistëve të kualifikuar për karrierë kryesisht në sektorin privat, por edhe atë publik dhe organizata të ndryshme, duke siguruar një arsimim të nivelit të lartë profesional, më dije bashkëkohore në fushën e kontabilitetit por edhe më gjerë.

Qëllimi i institucionit është të ofrojë arsimim cilësor nëpërmjet dijeve të qëndrueshme, kërkimit shkencor dhe inovacionit. Objektivat Strategjike të KU "Luarasi" janë: zhvillimi i filozofisë së brendshme, cilësia dhe performanca Akademike, Kërkimi shkencor dhe inovacioni, partneriteti dhe rekrutimi i studentëve dhe mundësitë e vazhimit të studimeve në KU. Të gjitha këto janë pjesë e Planit Strategjik të Zhvillimit për Kolegjin Universitar "LUARASI" 2016 -2020.

Objektivat e mësimdhënies së programit të studimit Master Profesional në "Kontabilitet" janë: Formimi i specialistëve të Kontabilitetit me aftësi teorike dhe praktike; pajisja e specialistëve me praktika nga tregu shqiptar dhe përvoja bashkëkohore ndërkombëtare dhe eksperiencat shqiptare në fushën e kontabilitetit, vlerësimit të pasurisë, financave personale, metodat e analizës së kostos; pajisja e studentëve me kompetenca të elementëve kontabël dhe sistemeve kontabël, njohuri mbi pasqyrat financiare të bizneseve. Fitimin e kompetencave në vlerësimin e pasurive dhe menaxhimin e financave personale.

Institucioni ka hartuar Scientific Research Strategy 2019-2024, ku janë përcaktuar objektivat e qarta të kërkimit shkencor. KU "Luarasi" synon të kryesojë hulumtime cilësore me interes kombëtar, rajonal apo global. Për të arritur këtë institucioni synon të krijojë lidhje të forta bashkëpunimi me partner të ndryshëm në nivel personal dhe institucional. Institucioni synon të rekrutojë kërkues shkencorë si dhe të mbështesë stafin ekzistues për një kërkim cilësor.

Në strategjitë dhe planet afatshkurtra zërthehen strategjitë afatgjata. Në planin afatshkurtër dhe afatgjatë, Kolegji Universitar "Luarasi" ka synuar dhe synon konsolidimin e Programit të studimit Master Profesional në "Kontabilitet", si një nga programet më të veçanta ofruar nga institucioni dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, për ta bërë të krahasueshëm me programet më të mira të kësaj fushe në vend e më gjerë. Gjithashtu në afat të shkurtër në planet vjetore synohet krijimi dhe zbatimi i një plani konkret për Ditët e karrierës nëshkollat e mesme me synim regjistrimine sa më shumë studentëve, pavarësisht zonave gjeografike apo qyteteve ku bëjnë pjesë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>GVJ konstaton se: Misioni i K.U “Luarasi” është t’u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm; t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira dijes dhe të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare.</p> <p>Programi i ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Kontabilitet”, është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit.</p> <p>Objektivat e mësimdhënies së programit të studimit Master Profesional në “Kontabilitet” janë: Formimi i specialistëve të Kontabilitetit, pajisja e specialistëve me praktika nga tregu shqiptar dhe përvoja bashkëkohore ndërkombëtare dhe eksperiencia shqiptare në fushën e kontabilitetit, vlerësimit të pasurisë, financave personale, metodat e analizës së kostos; pajisja e studentëve me kopetenca të elementëve kontabël dhe sistemeve kontabël, njohuri mbi pasqyrat financiare të bizneseve. Fitimin e kopetencave në vlerësimin e pasurive dhe menaxhimin e financave personale. Këto objektiva janë në përputhje me nevojat e tregut të punës, ndërkohë që programi i studimit është pjesërisht në përputhje me tregun e punës.</p> <p>Në Planin Strategjik të Zhvillimit për Kolegjin Universitar “LUARASI” 2016 -2020, është theksuar se për arritjen e objektivave bëhet analiza e tregut të edukimit dhe studimi i mundësive për programetë reja studimi apo kurse të veçanta profesionale.</p> <p>Për hapjen e programit të studimit institucioni është bazuar në Trendin e përgjithshëm të kërkesave për profesionin e kontabilistit në vite, në të dhënat statistikore të numrit të bizneseve në vend duke e pasur si bazë reference të tregut të punës.</p> <p>Institucioni ka marrë në konsideratë zhvillimin ekonomik të vendit që do të pasohet me rritje të numrit të të punësuarve në profesionin e kontabilitetit.</p> <p>Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit për Kolegjin Universitar “LUARASI” 2016 -2020 dhe programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” është në përputhje me strategjinë.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	

<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi i ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Kontabilitet”, është në përputhje të plotë me nivelin 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve. Ky program pajis të diplomuarin me njohuri të thelluara, profesionale në fushën e kontabilitetit dhe në përfundim studenti realizon punim diplome dhe i lëshohet diplomë “Master profesional” në “Kontabilitet”.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit për Kolegjin Universitar “LUARASI” 2016 -2020 dhe programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” i cili synon zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve. Plani Strategjik i Zhvillimit për Kolegjin Universitar “LUARASI” 2016 -2020 është hartuar në nivel institucioni dhe përmban objektivat për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit dhe mënyrat e arritjes së tyre.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. KU “Luarasi” ka për mision të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. 2. Programi i ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Kontabilitet”, është në përputhje me misionin e institucionit. 3. Për hapjen e programit të studimit, institucioni është bazuar në Trendin e përgjithshëm të kërkesave për profesionin e kontabilistit në vite, në të dhënat statistikore të numrit të bizneseve në vend duke e pasur si bazë reference të tregut të punës. 4. Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit për Kolegjin Universitar “LUARASI” 2016 -2020 në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve dhe rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit dhe programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” është në përputhje me planin strategjik. 	

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Piesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

KU “Luarasi” aktualisht ka në përbërje të strukturës së tij 3 (tre) Fakultete:

- Fakulteti Juridik
- Fakulteti i Ekonomisë
- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit

Secili nga Fakultetet ka në përberje të tij nga 3 njësi bazë. Secili departament ka në përbërje të tij 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët 3 janë të paktën me gradën shkencore “Doktor”.

Autoritete drejtuese akademike të KU “Luarasi” janë:

- Rektori
- Dekanët e Fakulteteve
- Përgjegjësit e departamenteve



Organet drejtuese akademike të institucionit janë: Senati Akademik dhe Asambleja e personelit akademik. Organe të tjera kolegjiale akademike janë Rektorati, Dekanati dhe Këshilli i Etikës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)

Ku Luarasi ka në përbërje të tij tre fakultete:

- ♣ Fakultetit të Drejtësisë
- ♣ Fakulteti Ekonomik.
- ♣ Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit

Autoritetet drejtuese të Fakultetit të Ekonomisë i cili ofron edhe Programin e ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Kontabilitet”, janë:

1. Dekani
2. Drejtuesi i njësisë bazë

Organi kolegjial drejtues është Asambleja e personelit akademik të Fakultetit Ekonomik.

Njësitë bazë përbërëse të Fakultetit të Ekonomisë janë:

1. Departamenti Financë-Bankë;
2. Departamenti Administrim Biznesi;
3. Departamenti Ekonomiks

Departamenti i Financë - Bankës është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit.

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Shiko Anekse, Tabela 1 dhe Tabela 2)

Departamenti i Financë-Bankës ka **7 pedagogë PAE**, nga të cilët 3 janë me grada/tituj (1 Prof Dr; 1 Prof As; 1 Dr; 4 Msc) dhe ka **16 pedagogë PAK** nga të cilët 5 pedagogë me grada/tituj (1 Prof Dr; 1 Prof As; 3 Dr; 11 Msc)

Departamenti Administrim - Biznesi ka 7 pedagogë PAE, nga të cilët 3 janë me grada/tituj (1 Prof. Dr; 1 Prof As; 1 Dr; 4 Msc) dhe ka 13 pedagogë PAK nga të cilët 6 pedagogë me grada/tituj (2 Prof As; 4 Dr; 7 Msc).

Departamenti i Ekonomiks ka 7 pedagogë PAE, nga të cilët 5 janë me grada/tituj (2 Prof Dr; 2 Prof. As; 1 Dr; 2 Msc) dhe ka 9 pedagogë PAK nga të cilët 4 pedagogë me grada/tituj (1 Prof Dr; 3 Dr; 5 Msc).

Nga të dhënat në RVB u konstatuan pasaktësi në grada dhe tituj të stafit akademik. Nga vizita në institucion na u komunikua që janë lapsuse në RVB. Nga Institucioni u ridërguan të dhënat për personelin akademik PAE dhe PAK (tituj dhe grada). Ndryshimet nuk ndikojnë në përmbushjen e standarteve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p>	<p>Organizimi i KU Luarasi mundëson përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të tij.</p> <p>KU Luarasi ka në përbërje të tij 3 fakultete:</p> <ul style="list-style-type: none"> — Fakultetin e Drejtësisë, — Fakultetin Ekonomik dhe — Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. <p>Secili nga Fakultetet ka nga tre njësi bazë (departamente):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Financë-Bankë;

<p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>2. Departamenti Administrim Biznesi; 3. Departamenti Ekonomiks</p> <p>Departamenti i Financë Bankës është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit. Departamenti i Financë-Bankës ka 7 pedagogë PAE, nga të cilët 3 pedagogë kanë të paktën e gradën shkencore “Doktor” dhe ka 16 pedagogë PAK nga të cilët 5 pedagogë kanë të paktën e gradën shkencore “Doktor”</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësitë bazë dhe kryesore për realizimin e programeve të studimit respektojnë përgjegjësitë të cilat janë të sanksionuara në Statutet e KU Luarasi, Rregulloren e KU Luarasi, Planin strategjik i zhvillimit për kolegjin universitar “Luarasi” 2016 - 2020 dhe Scientific Research Strategy 2019-2024.</p> <p>Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. Në çdo fund viti njësi bazë evidenton mangësitë për vitin akademik pasardhës dhe i drejton kërkesën drejtuesit të njësisë kryesore.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani përcaktojnë kriteret dhe Dekani i drejton kërkesën Rektorit. Pas miratimit të kërkesës nga Rektori Zyra e Burimeve njerëzore fillojnë procedurat për rekrutimin e ri. Dekani ngre komisionin <i>ad hoc</i> të përzgjedhjes. Vendimi i komisionit i njoftohet Dekanit dhe Rektorit, ky i fundit bënë edhe miratimin.</p> <p>Pedagogët vlerësohen nga asistimi i drejtuesit të njësisë bazë dhe kryesore si dhe drejtuesi i NJSBC-së dhe nga studentët.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. KU Luarasi aktualisht ka në përbërje të tij 3 Fakultete: Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Secili nga Fakultetet ka nga tre njësi bazë. 2. Departamenti i Financë- Bankës është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit. 3. Departamenti i Financë-Bankës ka 7 pedagogë PAE, nga të cilët 3 pedagogë kanë të paktën me gradën shkencore “Doktor” dhe ka 16 pedagogë PAK nga të cilët 5 pedagogë kanë të paktën me gradën shkencore “Doktor” 4. Njësitë kryesore dhe bazë realizojnë aktivitetin e tyre në bazë të Statutit dhe të Institucionit. 5. Si njësi kryesore edhe ajo bazë përfshihen si në procesin e rekrutimit të personelit akademik, ashtu edhe në procesin e vlerësimit të tij. 	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportet PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.



Personeli akademik që jep mësim në programin e studimit “Master Profesional” në “Kontabilitet”, është i përbërë nga pedagogë efektiv PAE dhe me kontratë PAK. Përzgjedhja e personelit akademik në procesin e mësimdhënies është e rëndësishme. Personeli akademik harton, diskuton dhe në fund konkludon për ndërtimin e syllabuseve të lëndëve, që përbëjnë thelbin e mësimdhënies. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime në mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillim për studentët, etj.

Personeli akademik gjatë angazhimit të tij dhe në zbatim të detyrave respekton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga statuti, rregulloret e institucionit dhe programeve dhe në përputhje me strategjinë për zhvillimin e institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat në aneks)

Për vitin akademik 2018-2019 që është edhe viti i parë për këtë program studimi, personeli akademik i angazhuar për programin e studimit është 11 pedagogë në total, ku 7 janë PAE (1 Prof. Dr; 2 Prof As; 2 Dr; 2 Msc) dhe 4 janë PAK (2 Prof Dr; 1 Prof. As; 1 Dr). Raporti numerik PAE/PAK është 63.6%/36.4%.

Ngarkesa e mësimin në programin e studimit për personelin akademik të programit të studimit MP në “Kontabilitet”, në pjesën më të madhe mbahet nga personeli akademik me kohë të plotë. Kështu pedagogët efektiv(PAE) kanë kryer 340 orë ose 70.8% të ngarkesës, ndërsa pedagogët me kontratë (PAK) kanë kryer 140 orë ose 29.2% të ngarkesës mësimore të programit të studimit.

Nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, vërehet se Ngarkesa në orë e pedagogëve të brendshëm në këtë program studimi, nuk është e lartë (minimalja 30 orë mësimore dhe maksimalja 60 orë mësimore). Ngarkesa totale në orë e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi, por edhe në programet e tjera që ofron KU Luarasi është minimalisht 120 orë (PAE Dr I. B) dhe maksimalisht 190 orë (PAE Msc E.T)

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit (Shiko Anekse, Tabela 3)

Programi i studimit ka Këshillin Shkencor të përbërë nga pedagogë me tituj dhe grada. Këshilli Shkencor përbëhet nga 5 Anëtarë (1 prof. Dr; 3 prof As; 1 Dr), nga të cilët njëri është Koordinator i programit (Prof As). Të gjithë anëtarët janë personel efektiv dhe me tituj dhe grada shkencore. Koordinatorin në programin e studimit “Master Profesional” në “Kontabilitet”, është autoriteti bashkërendues i veprimtarisë së programit të studimit.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Shiko Anekse, Tabela 4)

Në fillim të vitit akademik, me propozimin e njëjësive kryesore miratohet nga Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik miratohet nga Rektori. Personeli akademik që jep mësim në programin e studimit është i përbërë nga pedagogë me grada/tituj shkencorë dhe me Msc. Pedagogët me kontratë janë gjithsej 4, nga të cilët 3 janë të kategorisë Profesor, dhe një me gradë shkencore “Doktor”. Personel akademik efektiv janë gjithsej 7, nga të cilët 3 janë nga kategoria Profesor (1 Prof Dr; 2 Prof As), 2 me gradën shkencore Doktor dhe 2 me Msc, duke qenë 71% e pedagogëve PAE të angazhuar në program me grada dhe/ose tituj.

- Të dhënat sipas kualifikimit; seksit. Të dhëna sipas moshës së personelit (Anekse, Tabela 6; Tabel 6/1; Tabela 6/2)

Stafi akademik i përfshirë në programin e studimit është i moshës së re dhe mesatare. Veçanërisht stafi PAE është relativisht i ri. Në totalin e tyre dominojnë meshkujt. Meshkujt dominojnë në përbërjen e PAE ku janë 6 nga 7 pedagogë, pra rreth 86 % e PAE janë meshkuj. Në përbërjen e PAK dominojnë femrat 3 nga 4 apo 75% e PAK.

Gjatë vizitës u konstatua se këto tabëla në RVB kishin gabime, IAL ridërgoi tabelat pas vizitës në institucion. Tabela e ridërguar "Numri i PAK me moshë" ka të përfshirë 1(një) Asistentë me Msc me moshë (56-65), ndërkohë që në Tabelën 4 në (RVB): Stafit akademik për programin e studimit MP në "Kontabilitet" pwr vitin akademik 2018-2019 jepen 4 PAK dhe asnjw me Msc, tabelë e konfirmuar kjo edhe gjatë vizitës. GVJ ka bwrw korrigjimin nw Tabelwn 6/2 Numri i PAK me moshë, duke mos e përfshirë në tabelë: Asistentë me Msc me moshë (56-65).

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontrata e punës është mbështetur në Kodin e Punes, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e marrëdhënieve të punësimit të punonjësve si dhe dokumentacionin bazë të institucionit si Statutin dhe Rregulloren e Institutcionit. Kontratat administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

Kontrata e punës përcakton të drejtat dhe detyrimet midis palëve. Kontrata e punës nënshkruhet nga Rektori dhe i punësuari sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe rregullores se institucionit. Stafit akademik që zotëron titull akademik dhe gradë shkencore kanë kontrata pune pa afat ndërsa personeli akademik pa tituj dhe grada kanë kontrata me afat një vjeçar. Nga vizita në institucion u evidentua se kontratat e punës nuk përmbanin Disiplinën ku zhvillonte mësim stafit akademik PAE dhe PAK.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Personeli administrativ kryen veprimtari administrative dhe teknike në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor. Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështet veprimtarinë e mësimdhënies dhe të zhvillimit të institucionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 –Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe adminsitrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve.</p> <p>Personeli akademik është përgjegjës për hartimin e kurrikulave por edhe zbatimin e tyre në procesin mësimor.</p> <p>Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit ndihmon në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor nëpërmjet mbështetjes me bazë materiale me kushte të përshtatshme për zhvillimin e tyre. Ky personel merret më këshillimin e studentëve, me promovimin e institucionit, me aplikimin për projekte, etj.</p> <p>Si personeli akademik ashtu edhe ai ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit synojnë realizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe në përputhje me rregulloren e programit të studimit, objektivat e programit të studimit, që janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>
Standardi II.4 – Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Personeli akademik i programit të studimit ka rol përcaktues në hartimin e kurrikulave dhe ka rol aktiv në organizimin e programeve të studimeve.

Rekrutimi i personelit të ri akademik bëhet me propozim të përgjegjesit të departamentit duke specifikuar edhe kriteret. Kontrata e punës lidhet ndërmjet personelit akademik dhe Rektorit të KU Luarasi, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Rektori miraton edhe ngarkesën mësimore vjetore ndërkohë që Dekani mbikqyr realizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik.

Standardi III.1 – Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren. Përgjegjësi i departamentit i rekomandon dekanatit kriteret e posacme të pranimit të personelit akademik për departamentin, pas diskutimit paraprak në departament. Dekani ngre komisione ad hoc për procedurën e rekrutimit të stafit akademik. Më pas bëhet njoftim publik në media vizive dhe të shkruar. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është gjithsej 11, nga të cilët 7 janë pedagogë efektiv dhe 4 janë pedagogë me kontratë, raporti numerik PAE/PAK është 63.6%/36.4%.

Përsa i përket ngarkesës pedagogët efektiv (PAE) kanë kryer 340 orë ose 70.8% të ngarkesës, ndërsa pedagogët me kontratë (PAK) kanë kryer 140 orë ose 29.2% të ngarkesës mësimore të programit të studimit.

Ku Luarasi ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Për vlerësimin e personelit institucioni merr në konsideratë vlerësimin e bërë nga studentët dhe nga asistimi gjatë orës së mësimin nga drejtuesit.

Nga vizita në Institucion, në Zyrën e Burimeve Njerëzore na u komunikua se nuk kanë një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, por ka të dhëna mbi personelin PAE dhe PAK në vite, bazë kjo e krijuar nga Akreditimet periodike nga Agjencia e Akreditimit ASCAL.

Standardi III.2 – Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Kontabilitet” ofrohet nga Departamenti Financë-Bankë. Përgjegjësi i programit të studimit ka titullin “Profesor i Asociuar”.</p> <p>Titullarët e lëndëve të programit të studimit MP në “Kontabilitet” kanë në përgjithësi gradë shkencore/tituj akademik, 2 prej pedagogëve kanë Master Shkencor. Të gjithë pedagogët e lëndëve kanë një përvojë profesionale të gjatë dhe kompetenca në fushën e studimit që mbulojnë.</p> <p>Institucioni duhet të respektojë në lidhje me Titullarët e lëndëve ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3.</p> <p>Në KU “Luarasi, Rektori, zv/rektori, administrator i përgjithshëm dhe administratorët e fakulteteve, dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Ky program studimi është në vitin e parë të tij dhe numri i studentëve është i ulët. Institucioni ka personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>
<p>Standardi III.5 – Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentët tashmë janë në fund të studimit dhe janë duke punuar për temën e diplomës. Studentët kanë nga një udhëheqës për Temën e Diplomës. Në Evidencën 41 të dt 23.05.2019 janë dhënë përcaktimi i udhëheqësve të diplomës për secilin studentë.</p> <p>Udhëheqësit caktohen nga përgjegjësi i departamentit. Të gjithë udhëheqësit e Temave të diplomës kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht. Nga vizita në institucion, në takimet me drejtues dhe pedagogë konstatuam se drejtuesit udhëheqin 2-5 studentë gjithsej.</p>
<p>Standardi III.6 – Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Nga CV e stafit akademik fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet nga programi i studimit.</p> <p>Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>
<p>Standardi III.7 – Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Personeli ndihmës mesimor-shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështet veprimtarinë e mësimdhënies dhe të zhvillimit të institucionit.

Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore. Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. Në syllabuset e këtij programi studimi, nuk ka orë laboratorike por studentët i shfrytëzojnë laboratorët për punën e tyre të pavarur.

Standardi III.8 – Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në këtë program studimi vlerësohet me orë mësimore. Staf i akademik efektiv realizon 340 orë, ndërsa stafi akademik me kontratë realizon 140 orë mësimore.

Ngarkesa në orë minimale e pedagogëve të anagazhuar në këtë program studimi është 30 orë dhe maksimale është 60 orë. Ngarkesa në orë e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimo por edhe në programet e tjera që ofron ky institucion është 120 orë dhe maksimalja është 190 orë.

Standardi III.9 – Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni ka të dhëna të hollësishme mbi syllabuset, pedagogët që i zhvillojnë dhe Këshillin shkencor të programit.

Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ si dhe ngarkesën përkatëse.

Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik është përgjegjës për hartimin e kurrikulave por edhe zbatimin e tyre në procesin mësimor
2. Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit ndihmon në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor nëpërmjet mbështetjes me bazë materiale dhe kushteve të përshtatshme për zhvillimin e tyre.
3. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është gjithsej 11, nga të cilët 7 janë pedagogë efektiv dhe 4 janë pedagogë me kontratë, raporti numerik PAE/PAK është 63.6%/36.4%,

4. Ku Luarasi ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit si vlerësimi i studentëve, dhe asistimi në orën e mësimit.
5. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren.
6. Institucioni duhet të respektojë në lidhje me Titullarët e lëndëve ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3.
7. Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në këtë program studimi vlerësohet me orë mësimore. PAE kanë kryer 71% të ngarkesës, ndërsa pedagogët me kontratë kanë kryer 29% të ngarkesës mësimore.
8. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program PAE dhe PAK dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Kolegji Universitar “Luarasi” zhvillon aktivitetin në një godinë të vetme Godina e Kolegjit Universitar “Luarasi” është e lokalizuar në Rrugën “Elbasanit” ka një shtrirje prej 3787 m². Kjo Godinë ka qenë më herët Konvikti i Shkollës së Gjuhëve të Huaja dhe është marrë me qira nga Kolegji Universitar “Luarasi” që prej vitit 2013. Kjo godinë përbën njësinë kryesore dhe të vetme për personelin drejtues si: Rektorin, Dekanët, Përgjegjësit e Departamenteve dhe personelin akademik-administrativ.

Po në të njëjtën godinë zhvillohet edhe procesi mësimor. Për zhvillimin e programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Kontabilitet” janë vënë në dispozicion 3 sallat e leksioneve dhe 3 sallat e seminareve të katit të tretë të godinës, kat i cili është i dedikuar për Fakultetin Ekonomik. Sallat e leksioneve janë të pajisura me të gjithë mobilimet përkatëse, si me kompjuter, projektor, tavolina pune, karrige, tabelat e shpjegimit, si dhe posti i lektorit. Sallat e seminareve janë të projektuara me tavolinë rrumbullake në mënyrë që diskutimi i të gjithë pjesëmarrësve të jetë sa më interaktiv. Sallat e leksioneve kanë kapacitet më të madh. Meqënëse Masteri Profesional në “Financë dhe Menaxhim risku” ka 6 nga 8 lëndët të njëjta me Masterin Profesional në “Kontabilitet”, leksionet në këto lëndë janë zhvilluar në përgjithësi së bashku për të dy grupet e studentëve, ndërsa seminarat janë zhvilluar veçan dhe në sallat e seminareve me kapacitet më të vogël.

Pranë kësaj godine ndodhet Kabineti i Informatikës, i pajisur në total me 19 kompjutera/Laptope, 1 Server, 2 printera-fotokopje/skaner/printer, si edhe 1 projektor për rastet e zhvillimit të Leksioneve apo aktiviteteve të ndryshme që organizon KU “Luarasi”. Ky laborator shfrytëzohet nga studentët për punën e tyre të pavarur, si dhe për nevojat e printimit dhe fotokopjimit të materialeve të nevojshme për procesin mësimor.

Në këtë godinë ndodhet Biblioteka dhe një sallë leximi. Në Bibliotekë gjenden libra bashkëkohor shqip dhe në gjuhë të huaj, ndërsa në sallën e leximit gjenden periodikë. Biblioteka fizike është një bibliotekë modeste megjithatë ka tituj mjaftueshëm për programin e studimit MP në “Kontabilitet” dhe në institucion na u komunikua se kanë edhe bibliotekë on line. KU Luarasi është regjistruar në bibliotekën digjitale on-line Questia, dhe për këtë shfrytëzohet laboratori i informatikës, sepse biblioteka nuk kishte kompjutera. Në kohën e vizitës në institucion Biblioteka on line nuk funksiononte.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset që ofron KU Luarasi (Anekse, tabela 7) për Programin e studimit janë si më poshtë:

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë informatike
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyre informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Sic është përmendur më sipër për zhvillimin e programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional “Kontabilitet” janë vënë në dispozicion 3 sallat e leksioneve dhe 3 sallat e seminareve të katit të tretë të godinës. Numri i studentëve është i ulët dhe mund të konsiderohen mjaftueshëm. Lëndët nuk kanë orë laboratorit dhe nuk i kanë të nevojshëm laboratorët për lëndët. Në godinë nuk ka sallë interneti por studentët përdornin laboratorin e informatikës. Institucioni ka mundësuar shërbimin e internetit falas në godinë si për stafin ashtu edhe për studentët.

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Në godinë ka zyra për Dekanin dhe Administratorëdhe zyra për personelin akademik. Zyra për sekretarinë mësimore janë dy, njëra vetëm për ciklin e dytë të studimeve dhe tjetra për ciklin e parë të studimeve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 – Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arrijten e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ, ku janë të vendosura zyrat e rektorit, dekanit, dhe drejtuesve të tjerë si dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore.</p> <p>Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet. Evidenca 24.</p> <p>Kolegji Universitar “Luarasi” zhvillon aktivitetin në një godinë të vetme. Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	

Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Në syllabuset e lëndëve është e përcaktuar literatura bazë edhe ndihmëse. Në disa raste literatura e përcaktuar është e huaj dhe mundësohet on line apo si leksione të parashkruar nga pedagogu i lëndës.

Në rastet kur është përcaktuar tekst, KU "Luarasi" Institucioni siguron tekste mësimore cilësore.

Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e Temës së diplomës.

Në sallën e leximit ka botime periodike dhe na u komunikua gjatë vizitës se ka librari elektronike, por nuk funksiononte në kohën e vizitës. Evidenca 46 përmban manualin e përdorimit të Bibliotekës online.

Gjatë vizitës na u komunikua se librat në bibliotekë shtohen vazhdimisht. Evidenca 42 që i referohet RVB tregon literaturën bazë dhe ndihmëse të programit të studimit dhe nuk kemi një plan të detajuar të shtimit të zërave në bibliotekë. Nga vizita na u komunikua se Biblioteka regjistron kërkesat e studentëve për literaturë dhe këto kërkesa merren si bazë për blerjet e ardhshme. Gjatë vizitës u vu re se disa tituj të literaturës nuk ishin të viteve të fundit.

Biblioteka ka orare (8.30- 17.00) të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve, mësimi i këtij masteri fillon në orën 16.00 ndërkohë që biblioteka mbyllet në 17.00 dhe studentët kanë mundësi të marrin literaturën e kërkuar.

Sipas RVB Biblioteka funksionon me dy turne, por nga vizita na u saktësua se Biblioteka mbyllet në orën 17.00 por studentët mund të vazhdojnë të studiojnë në sallën e leximit.

Sipas RVB duke nisur nga viti akademik 2015 – 2016 KU "Luarasi" u siguron të gjithë personelit dhe studentëve aksesin në bibliotekën online "Questia", por nuk ishte funksionale kur ishim në institucion gjatë vizitës.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. Ky Master frekuentohet nga vetëm 12 studentë dhe infrastruktura është e bollshme për zhvillim të programit të studimit.

Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.

Në këtë program studimi nuk ka orë laboratorike. Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka një laborator informatike që studentët e përdorin për punën e tyre të pavarur.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Kolegjit Universitar "Luarasi" zhvillon aktivitetin në një godinë të vetme. Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit.
2. Institucioni në cdo rast që syllabusi ka tekst siguron tekste mësimore cilësore. Literatura duhet përditësuar.
3. Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës. Gjithashtu Institucioni na komunikoi se ka bibliotekë on line, por nuk funksiononte. Institucioni duhet të kujdeset për mbarëvajtjen e Bibliotekës on line në mënyrë që studentët të mund të sigurojnë literaturën e nevojshme dhe punojnë në mënyrë të pavarur
4. Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve.
5. Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Në Raportin financiar 2018, Evidenca 22, jepet situata financiare për dy vitet e fundit. Kolegji Universitar "Luarasi" ka rezultuar me fitim në dy vitet e fundit. Burimi kryesor i financimit janë të ardhurat nga tarifat e studimit të studentëve ndërsa të ardhura të tjera kanë nga kurse, trajnime, grante, pagesa vërtetimesh dhe diplomash, etj. Pasqyrat financiare të 2017 janë audituar dhe Raporti i Audituesit të pavarur (Evidenca 23) të pavarur garanton vërtetësinë e pasqyrave. Raporti i Audituesit të pavarur 2018 nuk është vënë në dispozicion si evidencë. Të ardhurat janë në rritje nga viti në vit si rrjedhojë e rritjes së numrit të studentëve, dhe pjesa më e madhe e tyre shkojnë për pagesat e pedagogëve.

Në RVB thuhet se disbalancat mbulohen nga pronari duke siguruar qëndrueshmëri financiare dhe vazhdimësi të aktivitetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje, jepen në Aneksë, tabela 8):
- Grantet për kërkim
 - Konsulencat, shërbimet
 - Tarifat për dhe gjatë shkollimit
 - Sponsorizimet
 - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
 - Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
 - Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Për sa më sipër, në anekse janë paraqitur të ardhurat për tarifat për dhe gjatë shkollimit për vitin 2018 dhe vitin 2019 dhe të ardhura të tjera për vitin 2018 dhe vitin 2019

Të ardhurat nga tarifat e studentëve përbëjnë rreth 97 % të të ardhurave gjithsej të Kolegjit Universitar "Luarasi".

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kosto e studimit për student duke marrë në konsideratë të gjithë studentët dhe kostot e Kolegjit Universitar Luarasi i llogaritur si raport i shpenzimeve për vit akademik dhe numrin e studentëve është 1,071 €/student, kjo e marrë nga RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 –Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Raporti i auditit për vitin 2017 paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Raporti i auditit jep opinionin se Pasqyrat Financiare paraqesin drejt aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin 2017. Evidenca 22, Raportin financiar 2018 paraqet të gjitha Pasqyrat financiare dhe shpjegimet përkatëse për zërat konkretë mbi të ardhurat. Raporti i auditit për 2018 u kërkua nga GVJ por nuk është në evidencat e dërguara nga institucioni më 05 Korrik 2019.</p> <p>Raporti i auditit jep opinionin mbi vërtetësinë e pasqyrave financiare. Pjesa më e madhe e të ardhurave shkon për pagesën e pagave të pedagogëve. Tek zëri shpenzime të tjera jepen edhe Botimet të cilat janë të rëndësishme për rritjen e cilësisë së studimeve.</p> <p>Raporti i Auditimit raporton se Pasqyrat financiare paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e parasë të shoqërisë KU “Luarasi”.</p>
Standardi VI.1 – Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj. RVB paraqet tabelën e përlogaritjes së kostove.</p> <p>Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Pasqyra e të ardhurave rezulton me fitim dhe në RVB është theksuas se disbalancat plotësohen nga pronari duke siguruar vijimësi.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ndërton Pasqyrat financiare për cdo vit kalendarik. Pasqyrat financiare auditohen nga një Auditues i pavarur. 2. Raporti i Audituesit jep opinionin se Pasqyrat Financiare 2017 paraqesin drejt aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë, performancën financiare dhe flukset monetare. Raportin financiar 2018 paraqet të gjitha Pasqyrat financiare dhe shpjegimet përkatëse për zërat konkretë të pasqyrave. 3. Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve, dhe siguron vijimësi. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) është një njësi akademiko-administrative, e cila kryen në mënyrë periodike realizimin, kontrollin, matjen dhe zhvillimin e cilësisë në KU "Luarasi". NJSBC përbëhet nga pesë anëtarë (Aneksa, tabela 9), ndërmjet të cilëve një ekspert i jashtëm dhe një student i përzgjedhur nga Këshilli i Studentëve të institucionit. Anëtarët e NJSBC zgjidhen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit. NJSBC është ngritur me vendim nr. 12/4, datë 23.12.2016 të Senatit Akademik. Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të NJSBC-së. Ngritja e NJSBC është e përcaktuar dhe e sanksionuar në Statutin e KU Luarasi ku përcaktohet se Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) është një strukturë përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore, kërkimore-shkencore, që i raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë Rektorit. Njësia gëzon autonomi operative dhe akses në të dhënat e institucionit. NJSBC përgatit raportin vjetor të vetëvlerësimit. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Objektivat strategjike të NJSBC-së janë: Përmirësimi në mësimdhënie dhe në mësimnxënie dhe Vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë edukuese në mësimdhënie.

Veprimtaria e NJSBC konsiston në mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të diplomuarve, intervistimin dhe mbikqyrjen e pedagogëve gjatë procesit mësimor dhe takime periodike me studentët, etj. Këto procese reflektohen në raportet vjetore që analizojnë statusin e institucionit ose/dhe të programit të studimit, përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- | | |
|---|----|
| <input type="checkbox"/> Sa anketime kanë bërë me studentët | 1 |
| <input type="checkbox"/> Sa studentë janë anketuar | 10 |
| <input type="checkbox"/> Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë | 50 |
| <input type="checkbox"/> Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm | |
| <input type="checkbox"/> Etj | |

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Sipas përcaktimit të Statutit të institucionit NJSBC, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, NJSBC organizon pyetësorin studentor përcilësinë e mësimdhënies, për lëndët e çdo programi studimi.

NJSBC përgatit raportin vjetor të vetëvlerësimit. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në raport NJSBC-ja udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raporti përmban sugjerimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Në mënyrë periodike bëhet vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nisur nga metoda të tërthorta, si opinionet e studentëve mbi kurrikulën, mbi mësimdhënien dhe metoda të drejtëpërdrejta si asistimin në auditor gjatë orëve të mësimit. NJSBC realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruaranga institucioni. NJSBC evidenton problematika, propozon mjete dhe procedura mbi bazën e legjisllacionit të arsimit të lartë, standardet e cilësisë, praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe zgjidhje

për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Praktikisht është zhvilluar vetëm një anketim i studentëve në fund të semestrit tëparë dhe janë përgjigjur 10 studentë për 5 lëndët e semestrit tëparë dhe janë përpunuar në këtë mënyrë 50 përgjigjet e tyre.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Vlerësimi i cilësisë dhe propozimet e NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete. Vlerësimi dhe ndjekja e cilësisë së mësimdhënies bëhet nga të gjitha hallkat drejtuese deri në nivel departamenti, përgjegjësi kjo e sanksionuar nga Statuti dhe Rregullorja e Institucionit.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Programi i Studimit Master Profesional “Kontabilitet” është në vitin e parë të aktivitetit të tij. Për vlerësimin e cilësisë database e marrë në konsiderate është bazuar kryesisht në vlerësimin e studentëve për nivelin e procesit mësimor në këtë institucion, në semestrin e I-rë të vitit akademik 2018 –2019. Plotësimi i pyetësorit bëhet në mënyrë krejtësisht konfidenciale dhe on-line. Me përfundimin e plotësimit të pyetësorëve, NJSBC përpunon të dhënat e vlerësimin për çdo pedagog.

Politikat e përmirësimin të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Pavarësisht se ky program studimi është në fillimet e veta institucioni ka të gjitha hallkat e ngritura për evidentim të problematikave dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Rezultatet e këtij viti do të shërbejnë si bazë për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi dhe në të gjithë institucionin.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi L.10 – Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimin dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimin, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimin të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/27ndu; 	<p>KU “Luarasi” përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p> <p>Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Institucioni nëpërmjet NJSBC harton Raportin e vlerësimin: Analiza e vlerësimin të cilësisë së mësimdhënies në shkollate larta mbi bazën e metodave statistikore. Ky raport nuk është bërë publik dhe është vetëm për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019.</p> <p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimin, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sondazh i studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazh që zhvillohet cdo fund semestër. ▪ Sondazhe të vlerësimin të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit. Këto sondazhe janë pjesë e pyetësorit on-line që ju drejtohet studentëve.

<p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit 28ndustries, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit – tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dëgjime në auditor. Nivelet drejtuese, përgjegjesi i departamentit, dekani dhe drejtuesi i NJSBC kanë hyrë në mësim për të dëgjuar zhvillimin e procesit mësimor në auditor. ▪ Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pike. Në Raport vjetor i kolegjit universitar “Luarasi”viti akademik 2017 -2018, analizohen edhe rezultatet e studentëve si në kalueshmëri ashtu edhe si përqindje të të diplomuarve për të gjithë institucionin. Në Analizen mbi rezultatet e studentëve në ku “Luarasi” për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019 vlerësohet edhe mesatarja dhe në këtë analizë jepet edhe analiza për rezultatet e studentëve tëMP në“Kontabilitet”.
Standardi I.13 – Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. Për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Institucioni harton rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm si Raport vjetor i Kolegjit Universitar “Luarasi” si edhe Analiza e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në shkollate larta mbi bazën e metodave statistikore, Analize mbi rezultatet e studentëve në KU “Luarasi” për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019. Këto broshura janë të hartuara por për qëllime të brendshme, nuk publikohen.</p> <p>Institucioni nuk publikon në faqe interneti Vlerësimin e Brendshëm.</p>
Standardi II.7 – Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë. Kjo analizë paraqitet në Raportin vjetor i kolegjit universitar “Luarasi” për vitin e kaluar. MP në “Kontabilitet” do të jetë pjesë e analizave vjetore në vijim.</p> <p>Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë. Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit për Kolegjin Universitar “Luarasi” 2016 -2020.</p>
Standardi VIII.1 – Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve.</p> <p>Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Institucioni, për kryerjen e</p>


<p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>vlerësimin përdor si metodat e drejtëpërdrejta ashtu edhe të tërthorta dhe në përfundim harton raport.</p> <p>Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të NJSBC i sigurimit të rritjes dhe cilësisë (2016-2020) ku është paraqitur politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Në Raportin vjetor të kolegjit universitar “Luarasi” paraqiten të dhëna mbi programet e studimit, të dhëna për pedagogët, lëndët, transferimet për dhe nga KU “Luarasi” si dhe numri i studentëve që e ndjekin, të dhëna që shërbejnë për të kuptuar ecurinë e tyre. MP në “Kontabilitet” është në vitin e parë të aktivitetit, pritet të analizohet dhe përmirësohet në vazhdim.</p> <p>Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë. Kështu vet përbërja e NJSBC është e tillë që marrin pjesë edhe pedagogë dhe një student.</p> <p>Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat të cilat janë përmendur më lart, nuk janë publikuar.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtëpërdrejta si plotësimi i pyetësorëve on-line nga studentët dhe asistimi në auditor nga drejtuesit. 2. Institucioni ka hartuar rregullisht broshura, buletine etj. Si Raport vjetor i kolegjit universitar “Luarasi”, Analiza e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në shkollat larta mbi bazën e metodave statistikore dhe Analiza mbi rezultatet e studentëve në KU “Luarasi” për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019. Raportet e vlerësimit të brendshëm nuk publikohen. 3. Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve 4. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të NJSBC i sigurimit të rritjes dhe cilësisë (2016-2020) me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. 5. Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat të cilat janë përmendur më lart, janë publikuar për qëllime të brendshme jo për publikun e gjerë. 	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë



auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Masteri Profesional në “Kontabilitet” në Kolegjin Universitar Luarasi është konceptuar që të plotësojë nevojat e studentëve të cilët kanë përfunduar ciklin e parë Bachelor dhe duan të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e profesionit të kontabilistit. Ky master është ndërtuar në përmbushje të kriterëve të një Masteri Profesional me 60 ECTS. (Evidenca 10). Ky program masteri ka si qëllim të përgatisë profesionistë të fushës së kontabilitetit të cilët të jenë të aftë të punojnë si kontabilistë në njësi të ndryshme ekonomike private apo edhe në institucione publike dhe financiare. Veprimtaritë formuese të paraqitura në RVB janë nga A – F dhe jo nga A – E sikurse i kërkon VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Viti i fillimit të programit të studimit të Ciklit të Dytë të studimit “Master Profesional” në “Kontabilitet” në K.U.Luarasi është viti akademik 2018-2019.

Qëllimi i programit “Master Profesional” në “Kontabilitet” është të përgatisë specialistë të profilit të kontabilitetit me njohuri të thelluara në fushat përkatëse të nevojshme për profesionin. Programi fokusohet në formimin e profesionistëve të rinj kontabël, të cilët do të duhet të pajisen me njohuritë dhe eksperiencat e nevojshme për të analizuar situatën financiare nëpërmjet pasqyrave financiare të firmave apo institucioneve. (Evidenca 10)

Objektivat formues të programit të ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Kontabilitet” janë të pasqyruar në mënyrë të zgjeruar në rregulloren e programit. (Evidenca 10). Në përmbajtjen e tyre këto objektiva përfshijnë formimin e profilit kulturor dhe profesional si edhe njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin:

a). *Formimi i profilit kulturor dhe profesional të studentit në përfundim të programit:*

Në këtë kontekst si objektiva formues të profilit kulturor dhe profesional përfshihen:

- Formimi i ekspertëve dhe i specialistëve cilësorë në aspektin teorik dhe veçanërisht në aftësitë e tyre praktike aplikative në fushën e kontabilitetit.
- Pajisja e studentëve me njohuritë moderne teorike, praktikat bashkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencës shqiptare në fushën e kontabilitetit, vlerësimin të pasurisë, financave personale, metodat e analizës së kostos, standarteve kombëtare e ndërkombëtare të kontabilitetit, kontabilitetin publik, atë të OJF-ve, etj.
- Zhvillimin tek studentët të njohurive e aftësive të gjera e të thelluara profesionale, për vlerësim kritik dhe mendim analitik të pavarur, aftësi për të zgjidhur probleme komplekse dhe për t’u rritur në karrierën profesionale;
- Hartimin e programeve të zhvillimit sipas standardeve të përafuara me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit;

b). *Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin.*

Me kompletimin e studimeve në këtë master, studentët, si specialistë kontabël do fitojnë disa kompetenca e cilësi, ndër të cilat, si me të rëndësishme veçojmë:

- kompetenca e njohuri të thelluara mbi standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit.
- aftësi të avancuara për analizën e pasqyrave financiare në aspektin e riskut financiar dhe masave për shmangien e tij.
- dije të thella profesionale për ushtrimin me kompetencë të detyrave dhe attributeve të audituesit ligjor dhe njohuri të plota teorike e praktike për menaxhimin kontabël të fondeve financiare në kompani dhe institucione.
- njohjen e parimeve dhe operimit të programeve informatike në fushën e kontabilitetit në aspektin e shfrytëzimit të informacionit në shërbim të analizës ekonomiko financiare, etj.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 50 minuta

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela 10,11,12 në Aneks)

Sipas Evidencës 14, Plani mësimor shtrihet në një vit akademik dhe përbëhet nga 8 lëndë mësimore plus Praktikën dhe Zhvillimin e Karrierës, plus Temën e Diplomës. Në këtë plan, grupi i lëndëve dhe i moduleve është kategorizuar në tipet e veprimtarive “A”, “B”, “C”, “D” dhe “E” (në ndryshim nga paraqitja e veprimtarive formuese në RVB ku ishin nga A – F).

Lëndët e kategorisë “A”, të cilat i përkasin Formimit të Përgjithshëm, në planin mësimor kanë 6 kredite ECTS (rreth 10% të numrit total të krediteve). Lëndët e Formimit Karakterizues ose profesional, pra ato të kategorizuara në grupin “B”, si grupi i disiplinave mësimore që i japin karakter të përveçëm krejt programit të studimeve, në planin mësimor-akademik përbëhen nga 4 lëndë, 21 kredite ECTS, (rreth 35 % të numrit të përgjithshëm). Lëndët e disiplinave të ngjashme dhe / ose integruese, (kategoria C), kanë 15 kredite ECTS (rreth 25%); ato të disiplinave të tjera formuese të grupit E kanë 6 kredite (10% të programit) dhe tema e diplomës, grupi F, 12 kredite (20% të totalit).

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 240 orë në auditor dhe 282 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 240 orë në auditor dhe 288 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet N/A orë në auditor dhe N/A orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën lëndore N/A orë në auditor dhe N/A orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 60 orë në auditor dhe 90 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar (Temë diplome) 120 orë punë në auditor dhe 180 orë punë e pavarur e studentit

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela ne Aneks 11)

Lënda e Kontabilitetit Nacional është ndryshuar me lëndën e Kontabilitetit të Drejtimit motivuar me faktin e nevojave që kanë studentët për t’u njohur me parime të kësaj lënde dhe avancimin e saj.(Evidenca 51)

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela ne Aneks 13)

Konstatohet se në përgjithësi formimi profesional i pedagogëve që japin mësim në lëndë të ndryshme (konstatuar nga CV të tyre si edhe nga kontrolli rastësor i disa prej dosjeve të personelit pranë Drejtorisë së BNj gjatë vizitës në Institucion), përputhen me lëndët që ata japin mësim. Ka disa përjashtime që kanë nevojë për rishikim. Nga diskutimet e bëra gjatë vizitës në Institucion, vetë Dekani e konstaton nevojën për përmirësime në këtë fushë dhe pranon që vitin e ardhshëm akademik do të ketë rishikime dhe përmirësime të stafit për ta pasuruar më tej atë.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Nga shqyrtimi i syllabuseve të dorëzuar për lëndët në MP në Kontabilitet, konstatohet se në përgjithësi syllabuset janë hartuar duke respektuar formën dhe përmbajtjen e nevojshme sipas rregulloreve dhe udhëzimeve në fuqi. Syllabuset në përgjithësi japin informacione për emërtimin e lëndës, vitin akademik dhe semestrin në të cilin zhvillohet kjo lëndë, emrin e pedagogëve që do të zhvillojnë leksionet dhe seminarët, bëjnë një përshkrim të njohurive paraprake që duhet të zotërojnë studentët dhe aftësitë shtesë që lënda do t'u ofrojë atyre, ngarkesa në auditor dhe format e mësimdhënies dhe mënyrat e vlerësimit të studentëve. Më pas syllabuset vijnë me listën e temave që do të trajtojnë lënda – disa prej syllabuseve kanë të detajuar edhe nënçështjet në përbërje të çdo teme, disa të tjera jo. Syllabuset mbyllen me detyrimet e studentit për lëndën si edhe me specifikimin e literaturës së detyruar dhe atë ndihmëse.

Në përgjithësi konstatohet një uniformitet për sa i përket paraqitjes së syllabuseve. Në përmbajtje të tyre megjithatë ka mungesë konsistence në të paktën dy elemente:

1. Detajimin ose jo të temave në nënçështjet përkatëse. Ky nuk është një element i detyrueshëm por shton vlerën e syllabuseve.
2. Në disa syllabuse konstatohen lapsuse (emërtime të gabuara të lëndëve, etj), të cilat ndikojnë negativisht në kuptueshmërinë e përmbajtjes së tyre.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e MP në "Kontabilitet" janë ndërtuar duke u përpjekur të orientojnë studentët në njohuri të fushës së kontabilitetit. Ky ka qenë edhe një ndër objektivat e hapjes së këtij programi studimi. Megjithatë, çfarë konstatohet gjithsesi është që pesha e lëndëve me sfond financiar mbizotëron në këtë master, përkundrazi lëndëve me sfond të profesionit kontabël. Kështu, nga 8 lëndë që zhvillohen, vetëm 3 lëndë janë në mënyrë të drejtpërdrejtë të profilit kontabël (Kontabiliteti i Drejtimit, Kontabiliteti Financiar i Avancuar dhe Standardet Ndërkombëtare Bankare dhe Financiare) duke qenë shumë pak për të plotësuar me dijet e nevojshme studentët e Masterit në Kontabilitet dhe gjithashtu të pamjaftueshme për të përmbushur objektivat e këtij programi studimi siç specifikohet edhe në vetë Rregulloren e MP në Kontabilitet (Evidenca 10). Ndërkohë plani mësimor paraqitet i pasur me lëndë që fare mirë mund të mos konsiderohen prioritare për një Master që synon të përgatisë profesionistë të kontabilitetit (si p.sh., Ekonometri e aplikuar, Metodologji Kërkimi në Financë) por që janë më shumë lëndë të formimit shkencor të studentëve dhe do të gjykoheshin më të përshtatshme për një Master Shkencor.

Në kundërshtim me çfarë shprehet në objektivat e programit të studimit, (Evidenca 10) konstatohet se në planin mësimor mungojnë lëndë që ofrojnë njohuri për kontabilitetin publik dhe atë të OJF, kontabilitetin e aplikuar (programet kompjuterike kontabël) dhe standardet kombëtare të kontabilitetit. Pra, nga analiza e përmbajtjes së syllabuseve konstatohet se orientimi drejt njohurive në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Legjislativitetit Tatimor dhe Doganor, Analiza e Pasqyrave Financiare si edhe softuerëve kompjuterikë aplikativë në kontabilitet mungon pothuajse plotësisht. Këto fusha konsiderohen tejet të rëndësishme dhe që duhet të njihen nga studentët që pritet të punojnë në profesionin e kontabilitetit në të ardhmen. Nga vizita në Institucion, pedagogë të departamentit por edhe studentë të MP në Kontabilitet, u shprehën se këto njohuri janë marrë nëpërmjet praktikave mësimore, por konstatohet se kjo nuk është një metodë e kënaqshme, pasi, meqenëse studentët kanë një lloj lirie për të zgjedhur vendin e praktikës, nuk garantohej se përfitim i njohurive të tyre në këto disiplina është uniform dhe as mund të sigurohej për këtë në mungesë të formave të vlerësimit të dijeve të përfutur gjatë praktikës mësimore.

Konstatohet se dy lëndë në planin mësimor mund të krijojnë lehtësisht mbivendosje me njëra tjetrën (Kontabiliteti Financiar i Avancuar dhe Standardet e Raportimit Bankar dhe Financiar). Syllabusi i kësaj të fundit ishte shumë i përmbledhur dhe mungon informacioni i detajuar për të gjykuar më shumë për përmbajtjen e lëndës.

Njëçështje tjetër që ka nevojë për përmirësim në syllabuse është zgjerimi i detajuar i temave mësimore. Në shumë syllabuse gjenden vetëm si tituj, pa dhënë mundësinë për t'u njohur me nënçështjet përbërëse të çdo kapitulli. Gjithashtu është e sugjerueshme dhe vlerështuese të bëhet edhe lidhja e temave mësimore me faqet e literaturës bazë të sugjeruar.

Nga GVJ është konstatuar se 6 nga 8 lëndët e programit të studimit MP në “Kontabilitet “ janë të njëjta me 6 nga 8 lëndët e programi të studimit MP në “Financë dhe Menaxhim Risku”, kjo gjë u konstatua sepse një nga ekspertët e GVJ ishte i njëjtë për të dy programet e studimit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

1. Syllabus Praktika MP ne Kontabilitet
2. Praktikat Mesimore Kontabilitet
3. Udheheqje Diploma Kontabilitet

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron programe të studimeve të organizuara në përputhje me misionin dhe qëllimin e vetë Institucionit (Evidenca 3).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” është me kohëzgjatje një vit akademik, me 60 kredite ECTS. (Evidenca 14)</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” i pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike. (Evidenca 14)</p> <p>Programi i studimit Master Profesional “Kontabilitet” ofron njohuri, aftësi dhe kompetenca të shtuara dhe të thelluara krahas njohurive të marra nga studentët më parë në programin e studimit Bachelor.</p> <p>Synimi kryesor i programit të studimit MP në “Kontabilitet” është t’i pajisë studentët me njohuri, aftësi dhe kompetenca teorike dhe praktike të lidhura ngushtë me kërkesat e tregut të punës. (Evidenca 10)</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” ka objektiva të qartë profesionale, të arritshëm, me synime të qarta dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. (Evidencë 10 dhe 11).</p> <p>Masteri Profesional ka nevojë, brenda hapësirave të lejuara, për rishikim të planit mësimor dhe të lëndëve të përfshira në të në mënyrë që të vijë sa më afër nevojave të tregut, konstatuar në studimin e tregut (Evidenca 11) dhe të formojë plotësisht profilin e një profesionisti kontabël.</p>
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p>	<p>Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimit Master Profesional “Kontabilitet” është pasqyruar në rregulloren e këtij programi dhe planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve përkatëse. (Evidenca 10 dhe 14)</p>

<p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm pasqyrohen në syllabus-et e lëndëve të programit të studimit. (Evidenca 31)</p> <p>Megjithatë theksojmë që mundet në këtë kontekst që në disa prej lëndëve, të shtohet pesha e pikëve të fituara nga studenti gjatë vitit dhe të pakësohet pesha e pikëve të provimit në fund.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensionet ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” është bazuar në përvojën disavjeçare të Institucionit, por nuk ka evidenca të dorëzuara që dëshmojnë të jetë bërë një studim i programeve të ofruara nga praktikatat e mira të vendeve europiane. Gjatë vizitës në Institucion, Dekani u shpreh se megjithatë, në hapjen e MP në Kontabilitet, K.U Luarasi është mbështetur në kurrikulat e ofruara nga Universitete të njohura të Italisë së Veriut.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” bazuar në objektivat kryesorë, planin mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to, metodatat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj, është konkurrenca në nivel ndërkombëtar pasi paraqitet pjesërisht i pajisur me elemente të kurrikulave të cilat kërkohen në përgjithësi edhe për certifikime ndërkombëtare në fushën e profesionit kontabël.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” paraqitet i hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe objektivat dhe legjislacionin e KU “Luarasi”. (Evidenca 2 dhe 3)</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” mund të përmirësohet më tej në lidhje me aftësimin profesional të studentëve duke pasuruar planin mësimor me më shumë lëndë të fushës aplikative dhe praktike në kontabilitet (SKK, Legjislacioni tatimor dhe doganor, Analiza e Pasqyrave Financiare, Softuerë kontabël dhe IT në Kontabilitet). (Evidenca 14)</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit MP në “Kontabilitet” angazhohet në punë kërkimore shkencore dhe në publikime dhe referime në konferencën e organizuar nga K.U Luarasi (Evidenca 36)</p> <p>Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për programin e studimit MP në “Kontabilitet” përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” duhet të përmirësohet duke pasur parasysh nevojat e tregut të punës për profesionistë kontabël që njohin mirë në radhë të parë kuadrin e raportimit kontabël kombëtar (meqënëse edhe shumica e bizneseve që operojnë në Shqipëri janë biznese të vogla dhe të mesme të cilat përdorin SKK); dhe deri diku atë ndërkombëtar; legjislacionin tatimor dhe doganor, impaktin e IT në kontabilitet dhe raportim financiar si edhe mundësinë e studimit të kontabilitetit publik dhe atij të OJF.</p>

Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>K.U “Luarasi” për vlerësimin e nevojave të tregut të punës për programin e studimit MP në “Kontabilitet”, ka kryer studimin e tregut për kërkesat e punëdhënësve dhe mundësitë e punësimit të studentëve. (Evidenca 11).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Kontabilitet” merr parasysh në mënyrë të pjesshme nevojat e tregut të punës në fushën e kontabilitetit, identifikuar në studimin e kryer nga ana e Institucionit. (Evidenca 11)</p> <p>Në planin mësimor të ofruar për Master Profesional në “Kontabilitet”, nuk reflektohen të gjitha gjetjet mbi nevojat e tregut të punës.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Nga sa paraqitet programi i studimit MP “Kontabilitet” i ofruar nga KU “Luarasi” nuk bie ndesh me interesat kombëtare. (Evidenca 14).</p> <p>Por gjithsesi ky program duhet të bëjë një punë më të mirë për të ruajtur vlerat kulturore dhe kombëtare në praktikën e kësaj fushe duke sjellë sa më shumë elemente nga praktika shqiptare në kontabilitet si psh: standardet kombëtare të kontabilitetit, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar, paketa softuerike kontabël shqiptare, tipare të kontabilitetit publik në vendin tonë etj). Këtë e dëshmojnë edhe gjetjet e vetë Institucionit në kërkimin e tregut (Evidenca 11).</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Kontabilitet” në K.U. Luarasi zgjat një vit akademik, me 60 kredite ECTS, në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p>
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>KU “Luarasi” i ofron studentëve informacion të plotë në lidhje me programin e studimit MP në “Kontabilitet”.</p> <p>Ky informacion ofrohet në forma të ndryshme, me shkrim dhe në mënyrë elektronike.</p>
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p>	<p>Programi i studimit MP në “Kontabilitet” parashikon qartë mënyrën e diplomimit të studentëve nëpërmjet përgatitjes së temës së diplomës sipas udhëheqjes së pedagogëve përkatës (Evidenca 10 dhe 14).</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> Programi është bazuar dhe orientuar pjesërisht nga nevojat e tregut të punës sipas studimit të bërë për këtë qëllim. Programi është ndërtuar në përputhje me strategjinë dhe objektivat e institucionit Programi është ndërtuar bazuar në planet mësimore dhe programet e lëndëve të cilat respektojnë legjislacionin shqiptar dhe atë të njohur në mënyrë ndërkombëtare Formimi i studentëve bëhet me njohuri të reja teorike të lidhura me realitetin shqiptar rajonal dhe më gjerë; 	

5. Institucioni ofron një informacion të gjerë mbi programin, ai zhvillohet mbi një plan të caktuar dhe në përfundim mbyllet me punimin e diplomës.
6. Programet kanë nevojë të pasurohen për të reflektuar më mirë nevojat e tregut të punës, si edhe objektivat e programit të studimit. Ky konkluzion u arrit edhe pas diskutimeve me pedagogët e programit, por edhe nga kërkesat e paraqitura nga vetë studentët e programit mësimor.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Konstatohet se mësimdhënia në K.U “Luarasi” organizohet sipas planit të programit mësimor. (Evidenca 14). Informacioni për programin e studimit dhe syllabuset e lëndëve të ofruara në këtë program janë të njohura paraprakisht nga studentët. Studentëve u prezantohet syllabusi i lëndëve, që në leksionin e parë. Në RVB, Institucioni shprehet se përdor dhe aplikacionin MOODLE ku pedagogët mund të ngarkojnë online të gjithë elementët e procesit mësimor, planin mësimor, syllabuseve, etj. (<http://moodle.luarasiuniv.edu.al>). (Evidenca 45). Por në vizitën e kryer në Institucion dhe nga bisedat me studentët, rezulton se ky aplikacion përdoret rrallë ose asnjëherë nga ana e tyre. Ata shprehen se janë më komodë me komunikimin nëpërmjet rrjeteve sociale (whatsapp), ose nëpërmjet emailve të përbashkëta të grupit.

Literatura e përdorur për lëndët është bashkëkohore dhe cilësore. Aksesi në Bibliotekën elektronike dhe atë fizike është i lehtë dhe i hapur për të gjithë. Studentët kanë mundësi për të fotokopjuar dhe printuar materiale sipas nevojave të procesit mësimor.

Plani mësimor i programit dhe personeli akademik përkatës publikohet në faqen zyrtare të webit të K.U “Luarasi”: www.luarasi-univ.edu.al. Studentët kanë qasje në sistemin wireless për të shfrytëzuar internetin në ambientet e Universitetit.

Mësimdhënia është e organizuar në leksione, seminare, dhe detyra kursi në varësi të lëndës. Sallat e leksioneve konstatohet se janë të pajisura me kompjutera dhe projektorë në funksion të pedagogut për shpjegimin e mësimin por edhe në funksion të studentëve (për prezantime detyrash kursi, projekte etj). Sallat e seminareve janë gjithashtu të pajisura pjesërisht me projektorë prezantimi dhe kanë mjaftueshëm priza për laptopët personalë të studentëve nëse ata e kanë të nevojshme të punojnë.

Vlerësimi i studentëve nga pedagogët e lëndës bëhet duke u mbështetur në disa elementë të cilat janë parashikuar në syllabus-et e lëndëve përkatëse të programit mësimor. Struktura e vlerësimit të studentëve me elementët përkatës pasqyrohet në syllabus, pavarësisht se jo çdo lëndë e programit ka të njëjtën shpërndarje të elementëve të vlerësimit përgjatë semestrit dhe në vlerësimin përfundimtar (Evidenca 31 dhe Evidencat 71-78)

Sipas syllabuseve dhe në përputhje me Rregulloren e Brendshme të K.U. Luarasi, studenti duhet të frekuentojë jo më pak se 75% të orëve të mësimin që të ketë të drejtë të futet në provim. (Evidenca 3). Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se në procesverbalet e vlerësimit të studentëve nuk cilësohej në mënyrë specifike statusi i studentit (nuk ka frekuentuar, nuk kualifikohet, apo nuk u paraqit). Në procesverbale shënohej vetëm NP – Nuk u paraqit, pavarësisht nëse studenti nuk kishte frekuentuar fare lëndën, nuk kualifikohet të hynte në provim, psh, për mungesë prezantimi të detyrave të kursit, apo thjesht nuk ishte paraqitur në provimin përfundimtar.

Për sa i përket cilësisë së mësimdhënies së pedagogëve në programin e studimit MP në “Kontabilitet” në K.U “Luarasi” bëhet një vlerësim për çdo semestër nga studentët. Përveç vlerësimit të studentëve me anë të pyetësorëve për pedagogët, bëhet dhe vlerësimi nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), duke

bërë kontrolle dhe vizita gjatë procesit mësimor. Gjatë vizitës në Institucion u informuam se kontrollet janë të dy llojeve, kontrolle të paralajmëruara dhe kontrolle surprizë. Gjatë këtyre kontrolleve përfaqësues të NJBSC sigurohen se pedagogët, kryesisht pedagogë të rinj, performojnë sipas pritshmërive në lidhje me përmbushjen e kriterëve të mësimdhënies dhe ngritjes profesionale.

Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies përbëhet nga vlerësimi i programit dhe vlerësimi i pedagogut. Vlerësimi menaxhohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të K.U “Luarasi”, nëpërmjet anketimeve, sondazheve, intervistave, etj., dhe në përfundim bëhet një analizë sasiore dhe cilësore e rezultateve, me qëllim evidentimin e problematikave dhe të fushave që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Një vlerësim i tillë që është praktikë e Institucionit, është kryer dhe për programin e studimit Master Profesional në “Kontabilitet”. (Evidenca 26, 27, 28 dhe 29).

Gjatë vizitës në Institucion, në diskutime me studentët u konstatua një rast problematik në mësimdhënie për një lëndë të caktuar. Studentët kërkuar ndryshimin e pedagogut, pa pritur përfundimin e semestrit apo plotësimin e formularit të vlerësimit dhe kjo kërkesë u reflektua menjëherë nga strukturat drejtuese të Institucionit.

K.U Luarasi ka parashikuar edhe vlerësimin e pedagogëve nga kolegët e tyre. (Evidenca 52). Por nga vizita në Institucion, gjatë diskutimeve me pedagogët, konstatuam se kjo praktikë nuk ushtrohet.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Për leksionet	240 orë në auditor dhe	282 orë punë e pavarur e studentit
Për Seminarët	240 orë në auditor dhe	288 orë punë e pavarur e studentit
Për Laboratorët	N/A orë në auditor dhe	N/A orë punë e pavarur e studentit
Për Praktikat lëndore	N/A orë në auditor dhe	N/A orë punë e pavarur e studentit
Për Praktikën Profesionale	60 orë në auditor dhe	90 orë punë e pavarur e studentit
Provimi përfundimtar (Temë diplome)	120 orë punë në auditor dhe	180 orë punë e pavarur e studentit

- Format e kontrollit të njohurive (Aneksë, tabela 15)

Format e kontrollit të njohurive për studentët janë paraqitur në syllabusët e lëndëve përkatëse (Evidenca 31). Një format i përgjithshëm vlerësimi përfshin vlerësimin gatë vitit dhe atë në fund dhe është paraqitur në tabelën 15 në Aneks.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Konstatohet se numri i studentëve të Masterin Profesional “Kontabilitet” ka qënë relativisht i vogël (12 studentë frekuentues) pasi ky është akreditimi i parë i këtij programi, pra vetëm për vitin akademik 2018-2019. Gjatë kësaj periudhe në RVB deklarohet se ka pasur vetëm një angazhim të studentëve të programit në punime shkencore individuale të pedagogëve por evidenca për këtë fakt nuk është dorëzuar dhe gjatë vizitës në Institucion u bëmë me dije se ky angazhim ka qënë një bashkëpunim informal mes një studenti dhe një pedagogu që nuk ka rezultuar në përfshirjen e emrit të studentit si bashkë-autor në punimin që pedagogu ka prezantuar në konferencën shkencore të K.U Luarasi të muajit maj 2019.

Konstatohet se në rang Departamenti apo Fakulteti nuk ka pasur projekte shkencore dhe as projekte shkencore në bashkëpunim me Institucione të tjera.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi dhe regjistrimi i aplikantëve në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në “Kontabilitet”, pranë K.U “Luarasi”, realizohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin Nr. 18, datë 17.08.2017 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Statutin dhe Rregulloren e KU “Luarasi”, si edhe Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në “Kontabilitet”. (Evidenca 10)

Programi Master Profesional “Kontabilitet” është një program i cili në K.U “Luarasi” është hapur për herë të parë për vitin akademik 2018-2019. Studentë aplikues në këtë program ishin 13 nga të cilët 13 u shpallën fitues. Mesatarja në hyrje e këtyre studentëve është 6,9. (Evidenca 48). Programi frekuentohet nga 12 studentë

Statistika të mëparshme për programin e studimit MP “Kontabilitet” apo Alumni të këtij programi nuk disponohen sepse është program i ri studimi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi i studentëve bëhet duke u bazuar në dokumentacionin e përcaktuar sipas Udhëzimeve të MASR si dhe kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucioni (Evidenca 10). Në këtë program studimi pranohen për t’u regjistruar shtetas shqiptarë dhe të huaj, që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. Përfundimi i shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).

2. Përfundimi i ciklit të parë, Bachelor në Ekonomi me programe të ngjashme me fushën e ekonomikut, si: Financë – Bankë, Kontabilitet, Ekonomiks, Administrim Biznes, Marketing, Menaxhim, Teknologji informacioni, Informatikë ekonomike, Informatikë, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me ato nga MASR, si dhe përfundimin e ciklit të dytë ose të tretë të studimeve në fushat e mësipërme.

3. Njohuritë formuese të aplikantëve duhet të konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve (jo më pak se 80 kredite).

4. Aplikanti duhet të zotërojë dëshmi të gjuhës angleze ose japin provimin e gjuhës angleze në përfundim të studimeve, Niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Theksojmë që ky kriter i fundit nuk përputhet me kërkesat e ligjeve në fuqi për Masterat Profesionale.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;

b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës. (Evidenca 10).

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Në program u pranuan gjithsej 13 studentë me një notë mesatare 6.9. (Aneks, tabela 17)

Programi nuk ka studentë të transferuar pasi është një program studimi një vjeçar.

Aktualisht programi ende nuk ka përfunduar (studentët ende nuk janë diplomuar) dhe nuk mund të përlllogaritet nota mesatare në dalje. Megjithatë për rezultatet e semestrit të parë janë publikuar statistikat përkatëse (Evidenca 48)

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Plotësoni Tabelën ne Aneks)

Në program janë regjistruar gjithsej 13 studentë. Pjesa kryesore e tyre kanë marrë tashmë numrat e matrikulimit nga QSHA, 12 studentë, ndërsa 1 është në proces matrikulimi (Evidenca Nr. 41 përmban të dhëna deri në muajin maj 2019 kur është dorëzuar dokumentacioni dhe tregon 4 studentë në pritje të matrikulimit. Konstatimi në sekretarinë mësimore të Institucionit në muajin korrik 2019 sjell këtë realitet të ri).

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Aktualisht programi ende nuk ka përfunduar dhe nuk ka studentë të diplomuar ende. Megjithatë nga konstatimi i realizuar pranë sekretarisë mësimore, verifikohet se një student, pavarësisht se është pajisur me numër matriculimi nuk ka frekuentuar studimet pranë KU Luarasi në asnjë prej lëndëve të semestrit të parë, apo të dytë.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Sipas Rregullores se Programit Mësimor pranë K.U “Luarasi” në MP në Kontabilitet pranohen për të ndjekur studimet universitare, edhe studentët që vërtetojnë me dokumente zyrtare, transferimin nga një institucion tjetër i arsimit të lartë publik ose privat. Për ata studentë që dëshirojnë të transferojnë studimet e tyre pranë KU “Luarasi”, institucioni ka ndërtuar strukturën e pranimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit përmes Komisionit të Ekuivalentimit të programeve mësimore. Nëse përputhshmëria e programeve i pajis studentët me kreditet e nevojshme, studentët regjistrohen për të vazhduar studimet në vitin akademik vijues, duke plotësuar njëkohësisht të gjitha kushtet e domosdoshme dhe specifike të pranimit të studentëve të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Sidoqoftë, në programin e Masterit Profesional në “Kontabilitet” nuk ka patur studentë të transferuar nga Institucionet e tjera të arsimit të lartë.

- Të dhëna për punësimin e studentëve

Në RVB nuk jepet informacion për punësimin e studentëve duke qenë se ky është një program i ri studimi. Gjatë vizitës në Institucion, megjithatë u konstatua se një pjesë e mirë e studentëve që kishin frekuentuar MP në Kontabilitet, ishin tashmë të punësuar.

- Numri total të diplomuarve

Aktualisht programi ende nuk ka përfunduar dhe nuk ka studentë të diplomuar ende.

- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Në RVB nuk jepet informacion për punësimin e studentëve duke qenë se ky është një program i ri studimi.

- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Në RVB nuk jepet informacion për punësimin e studentëve duke qenë se ky është një program i ri studimi.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Plani vjetor i punës për departamentin e Karrierës, viti akademik 2018-2019.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>K.U “Luarasi” pranon në programin MP në “Kontabilitet” studentët që zotërojnë së paku një diplomë Bachelor në Ekonomi dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS (Evidenca 10).</p> <p>Programi MP në “Kontabilitet” nuk është një program i integruar i studimeve.</p> <p>Të gjithë studentët e regjistruar pranohen në programin e studimit MP në “Kontabilitet” sipas kriterëve të përcaktuara nga K.U “Luarasi”. (Evidenca 10).</p> <p>Në programin e studimit Master Profesional në “Kontabilitet” studentët parashikohet se diplomohen pasi kanë paraqitur certifikatën e gjuhës së huaj sipas Udhezimit 52. Dt 03.12.2015.</p> <p>K.U “Luarasi” mund të rishikojë politikat e pranimit të studentëve bazuar në udhëzimet që dalin nga MASR dhe nga politikat vetjake të pranimeve të studentëve në programet master.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>K.U “Luarasi” i ofron informacion studentëve për statusin e institucionit, programeve të studimeve dhe për politikat e punësimit.</p> <p>Çdo studenti të KU “Luarasi” i jepet informacion në lidhje me akreditimin e institucionit dhe të programeve që në momentin e regjistrimit.</p> <p>K.U “Luarasi” ka marrë akreditimin institucional për 6 vite nga viti 2017 deri në vitin 2023. (Evidenca 6)</p> <p>K.U “Luarasi” ka zyrën e karrierës për studentët e cila mbulon gjithë universitetin dhe gjithë degët e studimeve.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>K.U “Luarasi” aplikon për herë të parë për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në “Kontabilitet”.</p> <p>Për programin Master Profesional në “Kontabilitet” ka statistika vetëm për vitin akademik 2018-2019 pasi ky është viti i parë për këtë program.</p> <p>Statistikat e mbajtura janë në lidhje me studentët e regjistruar në këtë program studimi, cilësinë e tyre në hyrje dhe numrin e studentëve që kanë frekuentuar semestrin e parë si edhe rezultatet e tyre në këtë semestër (Evidenca 33 dhe 48)</p> <p>K.U “Luarasi” disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve përgjatë vitit, duke nxjerrë rezultate për cilësinë e tyre dhe kalueshmërinë çdo semestër të vitit akademik (Evidenca 48)</p>

	<p>Siç edhe e kemi paraqitur në pjesën përshkrimore, në këtë Master janë regjistruar për herë të parë 13 studentë, nga të cilët vetëm 12 e kanë frekuentuar këtë program studimi. Nga rezultatet që GVJ vuri re në rregjistrine notave, ka përmirësime të notës mesatare të studentëve gjatë frekuentimit, në krahasim me notën mesatare të tyre në hyrje.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre; Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni ende nuk disponon një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programit MP në “Kontabilitet”, pasi ky është program i ri studimi dhe është viti i parë i studimeve.</p> <p>Për krijimin e bazës së të dhënave në K.U “Luarasi” është ngritur zyra e karrierës dhe ALUMNI. Pjesë e kësaj zyre janë pedagogë efektivë të KU Luarasi me një ndarje të qartë të detyrave duke filluar që nga viti i fundit akademik.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit; Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>K.U “Luarasi” vazhdimisht informon studentët në mënyrë të lidhje me programin e studimit MP në “Kontabilitet”. Informacioni është i publikuar online. KU “Luarasi” informon studentët për programin e studimit që në momentin e regjistrimit të tyre dhe gjatë procesit të studimeve.</p> <p>Në K.U “Luarasi” pedagogët dhe studentët diskutojnë hapur.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor; Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>K.U “Luarasi” angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve. Ky anagazhim është i përgjithshëm dhe konstatohet se studentët ndjehen të lirshëm që vërtet cdo shqetësim që kanë ta diskutojnë me pedagogët si edhe me strukturat drejtuese të Institucionit (dekani, përgjegjësi i departamentit).</p> <p>Në K.U “Luarasi” ekziston zyra e karrierës, e cila i vjen në ndihmë studentit për të zgjedhur institucionin në të cilin ata duan të vazhdojnë praktikën profesionale.</p> <p>Në lidhje me studentët e MP në Kontabilitet, kjo zyrë nuk është shumë funksionale pasi tashmë studentët janë të punësuar në pjesën më të madhe të tyre, por edhe ata që nuk janë të punësuar kërkojnë orientim tek pedagogët dhe drejtuesit e Institucionit.</p> <p>Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. Me Vendim Dekani janë përcaktuar 5 pedagogë për mbikëqyrjen e praktikave profesionale. (Evidenca 39)</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. K.U “Luarasi” ofron programe të studimeve të ciklit të dytë Master Profesional për të cilat ndjek procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve në programin Master Profesional në “Kontabilitet” bazuar në udhëzimet e përcaktuara nga MASR, dhe udhëzimet dhe kriteret e përcaktuara nga vetë institucioni.
2. K.U “Luarasi” i ofron studentëve informacion për statusin e institucionit, programin e studimit dhe për politikën e punësimit.
3. K.U “Luarasi” disponon të dhëna dhe statistika në lidhje me ecurinë akademike të studentëve në programin e studimit MP në “Kontabilitet”.
4. Në KU “Luarasi” studentët nuk arrijnë të kenë një nivel të lartë përfshirjeje (të paktën jo aq të lartë sa studentët e nivelit Bachelor), në jetën studentore për shkak të aktivizimit të tyre në punë. Kjo i bën të pa angazhuar me aktivitetet e jetës studentore. Mund të gjenden mënyra më të larmishme për t’i angazhuar studentët më shumë, si p.sh., panele të hapura, lektorë të ftuar të specialiteteve të kontabilitetit, etj
5. Në KU “Luarasi” është hapur zyra e studentëve dhe e karrierës e cila është në varësi të rektorit të cilit edhe i raporton. Zyra i vjen në ndihmë studentit për të zgjedhur institucionin në të cilin ata duan të ndjekin praktikën profesionale, por fokusi i studentëve të MP në Kontabilitet nuk është shumë kërkimi shkencor duke qenë studentë të masterit profesional.
6. Tre anëtarë të zyrës janë trajnuar dhe presin certifikim nga Risi Albania për këshillim karriere (Evidenca nuk është dorëzuar dhe certifikimi pritët në muajin shtator).

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikën e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Lidhja reciproke e punës kërkimore shkencore me mësimdhënien është shumë e rëndësishme dhe duhet të trajtohet me prioritetin e duhur nga ana e Institucioneve të Arsimit të Lartë. Stafit duhet të ndërmerret aktivitetet kërkimore që ndihmojnë dhe forcojnë mësimdhënien.

Kërkimi shkencor në K.U “Luarasi” zhvillohet në bazë të strategjisë së punës Kërkimore Shkencore për periudhën 2019 – 2024 (Evidenca 35) si dhe detajimit të saj në planin vjetor të punës kërkimore për vitin akademik 2018 – 2019 (Evidenca 34). Institucioni ka krijuar një njësi OJF - FAB për menaxhimin e projekteve të fituara. (Evidenca 34).

Politikat e kërkimit shkencor të hartuara nga K.U “Luarasi” dhe që kanë lidhje me aktivitetin e mësimdhënies në përgjithësi kanë synuar të arrijnë këto objektiva:

- Të përmirësojnë performancën shkencore të stafit akademik me dimensionet bashkëkohore dhe nivelin kërkimor evropian;
- Të reflektojnë këtë performancë shkencore në auditorët dhe punën interaktive me studentët;
- Të gjenerojnë kërkim shkencor, nëpërmjet organizimit apo pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të stafit akademik, botimit të revistës periodike të KU “Luarasi”, bashkëpunimit me lektorë të shquar vendas dhe të huaj për trajtimin e çështjeve aktuale të ekonomisë, të realizojë marrëveshjeve bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë për trajnimin dhe kualifikimin e stafit akademik.

- Të kthejë insitucionin në një qendër të vlerave elitare dhe konkurruese në tregun e arsimit të lartë kombëtar dhe më gjerë;

Në vitin akademik 2018 – 2019 K.U “Luarasi” ka organizuar një konferencë shkencore ndërkombëtare, në datën 08 maj 2019 më temë “Integrated Policy on Research and Innovation” (Evidenca 36).

K.U Luarasi ka një botim periodik („Mendimi“) në të cilën botojnë punimet e tyre stafi akademik apo studentët e këtij Kolegji, por një punë më e mirë mund të bëhet si në periodicitetin e tij ashtu dhe në tematikën e zgjedhur në të (specifikimi sipas tematikës përkatëse, etj.). Për këtë botim nuk gjenden të dhëna në Evidencat e dorëzuara (përveçse tek Raporti Vjetor 2017 - 2018). Nga vizita në Institucion gjatë diskutimeve me qendrën e projekteve rezultoi se për momentin botimi i periodikut është ndërprerë në pritje të marrjes së ISSN për botim online.

Në kuadrin e punës kërkimore – shkencore, K.U “Luarasi” shprehet në RVB se ka organizuar leksione të hapura me studentët si dhe forume të ndryshme duke ftuar pedagogë dhe personalitete të shquar shqiptarë apo të huaj. (Evidenca për këto organizime janë dorëzuar më vonë nga ana e Institucionit).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Kërkimi shkencor i përgjithshëm i Institucionit karakterizohet nga objektiva të qarta dhe strategji të mirëstrukturuar (Evidenca 34 dhe 35). Por në evidencat e dërguara paraprakisht mungojnë të dhënat për aktivitete konkrete faktike në lidhje me kërkimin shkencor. Nga takimi në Institucion dhe në bisedë me stafin e qendrës së projekteve dhe zv.rektorin për kërkimin shkencor u informuam për dy projekte ongoing: i pari i realizuar vitin e kaluar dhe i financuar nga Institucioni për vlerësimin online të pedagogëve dhe i dyti projekti “EU for innovation”. Evidenca faktike për këto projekte nuk janë dorëzuar.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Në RVB të dorëzuar nga Institucioni (tabela nr. 18) raportohen 25 botime të cilat lidhen në përgjithësi me të gjithë stafin e këtij IAL. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese u kërkuan evidenca faktike mbi kërkimin shkencor të pedagogëve të angazhuar specifikisht pranë programit të studimit MP në Kontabilitet. Pas vizitës në Institucion dhe kërkesës së GVJ, institucioni dorëzoi dokumentin: Evidenca e Punës Shkencore të pedagogëve të MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” dhe MP në “Kontabilitet”. Në këtë dokument jepen 10 botime të stafit akademik të lidhur me programin.

- Numri i projekteve kërkimore të fituara

Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohen 7 projekte kërkimore të fituara, por në një tabelë që shprehet se janë aktivitete të planifikuara. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion të faktuar për këto projekte kërkimore. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 në Aneks, të dhënat janë sipas RVB.

- Numri i projekteve të zbatuara

Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohen 7 projekte kërkimore të zbatuara, por në një tabelë që shprehet se janë aktivitete të planifikuara. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion të faktuar për këto projekte të zbatuara. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.

- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohen 10 aktivitete shkencore të organizuara nga K.U. Luarasi, por në një tabelë që shprehet se janë aktivitete të planifikuara. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim

shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion të faktuar për këto aktivitete shkencore. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohen 50 pjesëmarrës në aktivitete shkencore brenda Institucionit. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion të faktuar për këta pjesëmarrës. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Në tabelën 18 të dhënat janë sipas RVB.

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohen 29 kërkime shkencore gjatë procesit mësimor, por në një tabelë që shprehet se janë aktivitete të planifikuara. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion të faktuar për këto kërkime shkencore gjatë procesit mësimor dhe aq më pak të lidhura me programin e studimit MP në Kontabilitet. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar.

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohen 10 studentë të përfshirë në kërkimin shkencor. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion të faktuar për këtë. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar.

Numri i Çmimeve Kombëtare.

Në RVB të dorëzuar nga Institucioni raportohet 1 çmim kombëtar i fituar por jo i lidhur drejtpërdrejtë me programin e studimit MP në Kontabilitet, por i përgjithshëm për Institucionin. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese nuk janë të gjendje të ofrojnë informacion në lidhje me këtë çmim. Dekani i FE shprehet se nuk ka lidhje fare me programin MP në Kontabilitet. Evidenca faktike nuk janë dorëzuar. Për këtë arsye ky çmim nuk është përfshirë në tabelën 18 në shtojcë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Evidenca e Punës Shkencore të pedagogëve të MP në “Financë dhe Menaxhim Risku” dhe MP në “Kontabilitet”.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Personeli akademik i K.U “Luarasi” angazhohet në veprimtari shkencore të organizuar në mënyrë të përgjithshme dhe jo specifike për programin MP Kontabilitet. Personeli akademik i K.U “Luarasi” i angazhuar në mësimdhënien e lëndëve të MP në “Kontabilitet” është gjithashtu i angazhuar edhe në aktivitete kërkimore.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Aktualisht në K.U “Luarasi” programi nuk parashikon kurse në gjuhë të huaj (mësimdhënie në gjuhë të huaj). Por ai kërkon që personeli i angazhuar në mësimdhënie të zotërojë një certificate për njohje të avancuar të saj.</p> <p>Aktualisht në K.U “Luarasi” programi nuk parashikon kurse në gjuhë të huaj</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>K.U Luarasi organizon kurse dhe programe trajnimi për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik. Kryesisht këto programe janë zhvilluar në drejtim të metodologjisë së kërkimit shkencor si edhe në drejtim të mësimdhënies (Evidenca 49).</p> <p>KU “Luarasi” nxit personelin e tij akademik dhe mësimor për kualifikime të vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit. Marrëveshje mobiliteti Erasmus specifik për programin MP në Kontabilitet, aktualisht nuk ka, për shkak të natyrës specifike dhe kohëzgjatjes së shkurtër të këtij programi.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>K.U “Luarasi” deklaron në RVB se disponon një bazë të plotë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij. Por gjatë vizitës në Institucion strukturat drejtuese shprehen se kjo bazë të dhënash është aktualisht në përpunim e sipër.</p> <p>K.U “Luarasi” deklaron në Raportin Vjetor (Evidenca 30) se disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit MP “Kontabilitet” por nuk ka evidencë për këtë.</p> <p>K.U “Luarasi” nuk ka dorëzuar evidencë se disponon një bazë të dhënash për projektet brenda dhe jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit MP “Kontabilitet”</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. K.U “Luarasi” i kushton rëndësi të veçantë veprimtarisë shkencore dhe ndjek politika që synojnë arritje të objektivave të caktuara. 2. Në K.U “Luarasi” lidhja e punës kërkimore shkencore me mësimdhënien është në fokusin dhe qëllimin e tërë veprimtarisë së stafit akademik dhe të veprimtarive të ndërmara nga ana e tij me këtë karakter. 3. Për programin MP në Kontabilitet gjykohet se mungon lidhja e drejtpërdrejtë e kërkimit shkencor me objektivat e programit. Kjo justifikohet me llojin e programit i cili është një Master Profesional. 4. Për veprimtarinë kërkimore shkencore është ndërtuar strategjia e kërkimit shkencor për periudhën 2019 – 2014. Pjesë e kësaj strategjie është plani i punës kërkimore shkencore për vitin 2018 – 2019. 5. K.U “Luarasi” mbështet dhe nxit pjesëmarrjen aktive të stafit akademik si dhe studentëve në veprimtarinë kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit. Kjo është një politikë e përgjithshme që, për shkak të funksionimit të këtij programi për vetëm një vit akademik, ende nuk është konkretizuar me nisma konkrete. 6. Stafi FE angazhohet në kërkim shkencor dhe rezultojnë me 10 publikime shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program dhe studentët janë të përfshirë në kërkim shkencor përmes punimeve të tyre të diplomës 	

7. K.U "Luarasi" shprehet se në vitet e fundit po krijon një data bazë të detajuar të punës kërkimore shkencore, botime, projekte, etj. të realizuar nga stafi akademik si dhe nga studentët.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

K.U "Luarasi", ka pasur prioritet zgjerimin e bashkëpunimit në planin kombëtar edhe atë ndërkombëtar, duke lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me Institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëveshje mund t'i shërbejnë në tërësi K.U Luarasi por edhe programeve specifike të studimit, që ai ofron.

Kështu, në mbështetje dhe funksion të programit të studimit Master Profesional në "Kontabilitet", K.U "Luarasi", ka nënshkruar disa marrëveshje për bashkëpunim me institucione të rëndësishme në Shqipëri, si: Marrëveshja e bashkëpunimit me "Kontrolli i Lartë i Shtetit", Marrëveshja e bashkëpunimit me "Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare", dhe Memorandumi i bashkëpunimit me Ministrinë për "Inovacionin dhe Administratën Publike". (Evidenca 37).

Njëkohësisht K.U "Luarasi" ka marrëveshje bashkëpunimi afatgjata edhe me Institucione të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, si: Marrëveshja e bashkëpunimit me "L'Universita degli Studi di Bari "Aldo Moro", Memorandumi i bashkëpunimit me Universitetin "Eqerem Çabej" - Gjirokaster, dhe Memorandumi i bashkëpunimit me Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër. (Evidenca 38).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare

Asnjë pjesëmarrje si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare

- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj

Në RVB të dorëzuar nga Institucioni (tabela nr. 19), raportohen 5 orë mësimore me lektorë të huaj. Gjatë takimeve në Institucion, me zv.rektoren për kërkim shkencor por edhe me pedagogët dhe struktura të tjera drejtuese u kërkua informacion i faktuar për këtë. Pas kërkesës së dokumentacioneve nga GVJ institucioni ka ngarkuar dokumentin *Aktivitetet dhe leksione të hapura*, por është një dokument që nuk evidenton nëse këto aktivitete janë zhvilluar në vitin akademik 2018-2019, dhe në disa raste pa specifikuar Lektorin përkatës.

- Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
- Asnjë pjesëmarrës në trajnime jashtë vendit për kërkimin shkencor

- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL

Në tabelën 19 jepet se 1 student ka zhvilluar mobilitet por gjatë vizitës u informuam se KU "Luarasi" është pjesë e rrjetit ERASMUS por deri tani nuk ka pasur mobilitete pedagogësh apo studentësh për këtë program studimi.

- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor

2 laboratore

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

Asnjë pjesëmarrës në aktivitete shkencore jashtë IAL apo jashtë vendit.

- Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor - Asnjë

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Në mbështetje dhe funksion të programit të studimit Master Profesional në "Kontabilitet", K.U "Luarasi" ka nënshkruar 3 (tre) marrëveshje për bashkëpunim me këto Institucione: “Kontrolli i Lartë i Shtetit”, “Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare” (AMF), Ministria për “Inovacionin dhe Administratën Publike” dhe 4 (kater) me komunitetin e biznesit (tregu i punës). (Evidenca 37)</p> <p>Programi i ofruar është i ciklit Master Profesional</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Në statutin dhe rregulloren e brendshme të K.U Luarasi janë përcaktuar organizimi i institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike si dhe të autoriteteve drejtuese të institucionit, të njëjve kryesore dhe të njëjve bazë. (Evidenca 2 dhe 3)</p> <p>Në këto evidenca konstatohet se funksionet dhe veprimtaritë e secilit prej organeve drejtuese, organeve kolegjiale, organeve administrative, janë përcaktuar qartë duke specifikuar: ndarjen e detyrave mes personelit brenda institucionit; marrjen e përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>K.U "Luarasi", ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaja, por edhe me Universitete dhe Kolegje jashtë Shqipërisë. (Evidenca 37)</p> <p>Bashkëpunimi ka mundësuar kryerjen e praktikave profesionale, internshipe apo stazhe për studentët, pavarësisht se studentët e MP në Kontabilitet janë tashmë të punësuar në një masë të lartë. Për ata që kanë pasur nevojë, Institucioni e ka mundësuar vendin e praktikës.</p> <p>Nga takimi në Institucion na u tha se janë zhvilluar trajnime për studentët por kjo nuk evidentohet me dokumenta.</p> <p>Nga evidencat nuk kemi informacion në lidhje me raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale, por programi i studimit është në vitin e parë të tij ndaj mbetet për të parë përfitimet në vitet e ardhshme.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. K.U "Luarasi" i kushton rëndësi të veçantë realizimit të programit të studimit Master Profesional në "Kontabilitet", si dhe krijimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit për të garantuar cilësi në këtë program studimi, pavarësisht se është një program studimi i ri.
2. Për kryerjen e praktikave të studentëve, K.U "Luarasi", ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme brenda vendit dhe ka nënshkruar për këtë qëllim disa marrëveshje bashkëpunimi të cilat sipas informacioneve të marra gjatë vizitës në Institucion pritet që të fillojnë të konkretizohen duke nisur nga shtatori i vitit të ardhshëm akademik.
3. Bashkëpunimi me keto institucione dhe kompani është zgjeruar jo vetëm në aspektin akademik, ashtu edhe në atë të formimit profesional të studentëve nga këndvështrimi i realizimit të praktikave mësimore.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Etleva Bajrami

2. Prof.Asoc.Dr. Rezarta Shkurti



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a. Pika të forta:

- 1) Staf i akademik i Institucionit i cili është i përkushtuar për të rritur vlerën e përgjithshme të Kolegjit Universitar Luarasi.
- 2) Përpjekje për rritjen e vazhdueshme të nivelit të kualifikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të strukturës së stafit me tituj dhe grada.
- 3) Mbështetja e Grupit të Biznesit ku bën pjesë Kolegji Universitar "Luarasi" gjë që faciliton kryerjen e praktikave profesionale për studentët, rritjen e vizibilitetit dhe përmirësimin e imazhit të Institucionit përmes kompanive media të grupit, si edhe pasurimin e jetës akademike me evente dhe ngjarje të tilla si prezantime, forume diskutimi, etj.
- 4) Marrëdhënie ndërpersonale të mira të stafit si edhe komunikim interaktiv staf – studentë që rrit cilësinë e jetës akademike.
- 5) Pozicionimi pranë zonës urbane që lehtëson aksesin në facilitetet e IAL, si dhe pranë Qytetit Studenti si një treg i synuar potencial.

b. Pika të dobëta:


- 1) Mospërditësi i syllabuseve dhe përmbajtjes së disa prej lëndëve të kontabilitetit në reflektim të kuadrit kontabël kombëtar dhe më konkretisht, Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.
- 2) Mungesa e burimeve të të ardhurave nga kërkimi shkencor dhe projekte kërkimore të financuara nga Institucione të huaja.
- 3) Numri i ulët i marrëveshjeve me Institucionet Publike dhe Private brenda dhe jashtë vendit, gjë që limiton mundësitë e studentëve të programit të studimit për të kryer praktikat profesionale, internshipe apo vizita studimore pranë bizneseve.
- 4) Vështirësi në gjetjen e stafit të përgatitur profesionalisht dhe njëkohësisht edhe me tituj akademikë, pasi për vetë specifikat që ka, në programin e studimit MP në Kontabilitet do ishte me vlerë angazhimi në mësimdhënie të specialistëve të fushës, por që nga ana tjetër nuk kanë tituj dhe grada cka kufizon përfshirjen e tyre.
- 5) Pamundësia për të lidhur më mirë dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë kërkimin shkencor me programin e studimit MP në Kontabilitet dhe mungesa e një buxheti të dedikuar për kërkimin shkencor.
- 6) Përdorimi i kufizuar i platformës elektronike Moodle LMS për shkëmbimin e materialeve mes pedagogëve dhe studentëve në një mënyrë formale, të besueshme dhe të kontrollueshme.

c. Mundësitë:

- 1) Ofrimi i lëndëve me afër kerkesave të tregut të profesionit kontabël në Shqipëri, si edhe kerkesave të certifikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit.
- 2) Zgjerimi i marrëveshjeve Erasmus për stafin që është i angazhuar në mësimdhënie në programin MP në Kontabilitet.
- 3) Angazhimi i profesionistëve kontabël dhe specialistëve të njohur të fushës për leksione të caktuara sfiduese me statusin e lektorit të ftuar (guest lecturer).
- 4) Përmirësimi dhe rritja profesionale e stafit të angazhuar në mësimdhënie pranë këtij programi, sidomos stafit të ri në tituj dhe grada.
- 5) Përfshirja e studentëve të programit të studimit MP në Kontabilitet në aktivitete shkencore me interes për fushën e tyre si edhe në ngjarje dhe organizime të ndryshme studentore në Institucion.

d. Pengesat:

- 1) Treg që po shkon me shpejtësi drejt ngopjes përsa i përket programeve të studimit master profesional në fushën e Kontabilitetit cka nënkupton konkurrencë të fortë në të ardhmen e afërt.



- 2) Promovimi i Universitetit dhe ndërtimi i një imazhi të qëndrueshëm dhe premtues për cilësi në disiplinën e kontabilitetit.
- 3) Mungesa e burimeve të diversifikuara të të ardhurave dhe mbështetja kryesisht në të ardhurat nga tarifat e studimit.

REKOMANDIME:

- 1) Përditësimi i literaturës me botime të viteve të fundit të cilat reflektojnë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara dhe Ligjin e ri Nr. 25/2018. *Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.*
- 2) Shtimi i të ardhurave nga aktivitetet e kërkimit shkencor dhe projekteve si pjesëmarrje individuale e Institucionit apo edhe në bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- 3) Rritja e numrit të personelit akademik sepse është në minimumin e lejuar dhe rekrutime të reja të cilat rekomandohen të jenë në kategorinë Profesor në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, neni 59, pika 3.
- 4) Mund të gjenden mënyra më të larmishme për t'i angazhuar më shumë studentët e programit MP në Kontabilitet në aktivitete me interes për fokusin e tyre, si p.sh., panele të hapura dhe tryeza diskutimi me aktorë të sferës së kontabilitetit në Shqipëri (konkretisht përfaqësues nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit - KKK, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar - IEKA, etj), lektorë të ftuar të specialiteteve të kontabilitetit, etj.
- 5) Promovimi i shfrytëzimit të platformës elektronike Moodle LMS për shkëmbimin e materialeve mes pedagogëve dhe studentëve pasi kjo sjell një kulturë të komunikimit formal, të kontrolluar dhe të besueshëm mes palëve të përfshira.

SUMMARY ANALYSIS FOR IMPLEMENTATION OF THE STUDY PROGRAMME

Summary analysis for implementation of the study programme according the SWOT methodology (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

a. Strengths:

- 1) The academic staff of the Institution appears to be committed to enhancing the overall value of the Institution.
- 2) Continuous strategy to increase the level of qualification of existing staff and to improve the academic structure by hiring staff with scientific degrees and academic titles.
- 3) Support from the Business Group (KUL is one of the many entities of this group) which facilitates the implementation of professional internships for students, enhances the visibility and improves the image of the Institution through the media branch of the group, as well as enriches the academic life with events such as presentations, discussion forums, etc.
- 4) Good staff interpersonal relationships as well as interactive staff - student communication that contributes to increase the quality of academic life.
- 5) Geographic positioning close to the urban area that facilitates access to HEI premises as well as close to the Student Dormitories (Qyteti Studenti) as a potential targeted market.

b. Weaknesses:

- 1) Non-updated syllabuses and contents of some of the accounting modules reflect non-updated national accounting framework terminology and more specifically, National Accounting Standards.
- 2) Lack of income sources from scientific research activities and lack of research projects financed by foreign Institutions.
- 3) Few cooperation agreements with either domestic or foreign Public and Private Institutions that limit the opportunities of this study program students to conduct professional internships, study visits to businesses.

- 4) Difficulties in finding professionally trained staff, who are also qualified in terms of academic titles and / or holding scientific degrees; due to its specific nature the students of this Professional Master in Accounting would benefit from the involvement in the teaching process of highly qualified accounting professionals, yet these individuals do not hold academic titles and degrees what inhibits their involvement as instructors of the study program.
- 5) Incapability to better and more efficiently establish direct connections between the scientific research activities and this specific study programme (Professional Master in Accounting) and lack of a dedicated budget for scientific research.
- 6) Limited usage of Moodle LMS electronic platform between students and instructors what in turn, limits the reliable exchange of course materials and updates in a controllable and formal mode.

c. Opportunities:

- 1) Including modules/courses in compliance with the accounting profession market needs in Albania as well as with the requirements of national and international certification in the Accounting profession.
- 2) Extension of the Erasmus agreements to staff engaged in teaching at the Professional Master in Accounting programme.
- 3) Including recognized professionals and specialists from the Accounting profession in Albania as guest lecturers for specific challenging topics.
- 4) Improvement and professional enhancement of staff engaged in teaching under this program, especially new staff in titles and degrees
- 5) Including more students of this study programme in scientific activities of their interest and also in various students events at the Institution.

d. Threats:

- 1) The education market in Albania is quickly evolving toward its maturity regarding professional accounting master's degree programs, which means stronger competition for the Institution in the near future
- 2) Promoting the University and building a consistent and promising image of excellence as for the accounting discipline.
- 3) Lack of diversified sources of income and reliance mainly on income from the study fee.

RECOMMENDATIONS:

- 1) Updating the required literature with recent publications reflecting the revised National Accounting Standards (NAS) of Albania and the new Law no. 25/2018. On Accounting and Financial Statements.
- 2) Increasing the income from research activities and projects either as individual participation of the Institution or in collaboration with national and international partners.
- 3) Increasing the number of academic staff because it is at the minimum required through hiring new staff members possibly holding the *Professor* academic title in accordance with the requirements of the Law no. 80/2015, dated 22.07.2015, Article 59, paragraph 3.
- 4) More original ways can be found to engage the students from this study program in activities with a focus in line with their interests, such as discussion panels and roundtables with recognized stakeholders in the field of Accounting in Albania (specifically representatives from the National Accounting Council - NAC, Institute of Chartered Accountants - IEKA, etc.)
- 5) Promoting the use of the Moodle LMS electronic platform for the exchange of materials between lecturers and students as this creates a culture of formal, controllable and reliable communication between the parties involved.